



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

[www.qbz.gov.al](http://www.qbz.gov.al)

**Nr. 79**

**14 maj**

**2013**

## P Ë R M B A J T J A

|                                     | Faqe                                                                                                                                                                                                                                                    |
|-------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Ligj nr. 132/2013<br>datë 29.4.2013 | Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8537, datë<br>18.10.1999 “Për barrët sigurorese”, të ndryshuar ..... 3379                                                                                                                                   |
| Ligj nr. 133/2013<br>datë 29.4.2013 | Për sistemin e pagesave..... 3380                                                                                                                                                                                                                       |
| Ligj nr. 134/2013<br>datë 29.4.2013 | Për ratifikimin e marrëveshjes së kredisë së eksportit ndërmjet<br>Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave,<br>dhe Erste Bank Der Oesterreichischen Sparkassen AG për<br>projektin e tatimit elektronik (E-Taxation) ..... 3391 |

**LIGJ**  
**Nr. 132/2013**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR. 8537, DATË 18.10.1999**  
**“PËR BARRËT SIGURUESE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 8537, datë 18.10.1999 “Për barrët siguruese”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

**Neni 1**

Në nenin 1 dhe në të gjithë ligjin termat “pasuri e paprekshme”, “instrument”, “letër me vlerë” dhe “llogari” shfuqizohen.

**Neni 2**

Në nenin 4, pas shkronjës “e” shtohet shkronja “ë” me këtë përmbajtje:  
“ë) marrëveshjet e kolateralit financiar, të rregulluara me ligj të posaçëm.”.

**Neni 3**  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 29.4.2013

**Shpallur me dekretin nr.8165, datë 13.5.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,**  
**Bujar Nishani**



**LIGJ**  
**Nr. 133/2013**

**PËR SISTEMIN E PAGESAVE<sup>1</sup>**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

**Qëllimi**

Ligji synon të nxisë sigurinë, qëndrueshmërinë dhe efikasitetin e sistemit kombëtar të pagesave në Shqipëri.

**Neni 2**

**Objekti**

1. Ligji përcakton parimet bazë që kanë të bëjnë me licencimin, rregullimin, mbikëqyrjen e elementeve të rëndësishme të sistemit kombëtar të pagesave, si dhe përcakton rregullat për mbrojtjen e sistemeve.

2. Në mënyrë të veçantë, dispozitat e kreut IV të ligjit rregullojnë të gjitha rastet e marrëveshjeve të kolateralit financiar.

**Neni 3**

**Bashkëpunimi ndërinstitucional**

Banka e Shqipërisë, në përmbushjen e detyrave të saj, të përcaktuara në këtë ligj, bashkëpunon me cilindo autoritet vendas dhe/ose të huaj, me qëllim shkëmbimin e informacionit, bashkërendimin e veprimtarive, apo realizimin e marrëveshjeve të tjera të bashkëpunimit, nëse gjykohet e nevojshme.

---

<sup>1</sup> Ky ligj është përafëruar plotësisht me:

Direktivën 98/26/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 19 maj 1998 “Mbi finalizimin e shlyerjes së pagesave dhe të titujve në sistemet e shlyerjes”, të ndryshuar. Numri CELEX: 31998L0026, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 166, datë 11.6.1998, faqe 45 – 50.

Direktivën 2002/47/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 6 qershor 2002 “Mbi marrëveshjet financiare të kolateralit”, të ndryshuar. Numri CELEX: 32002L0047, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 168, datë 27.6.2002, faqe 43–50.

#### Neni 4

### Komiteti Kombëtar i Sistemit të Pagesave

Banka e Shqipërisë mund të krijojë një komitet kombëtar për sistemin e pagesave, duke përcaktuar objektivat, funksionet, detyrat, përbërjen dhe rregullat për funksionimin e tij.

#### Neni 5

### Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Bankë” është personi juridik, përfshirë degët e bankave të huaja, i licencuar për të ushtruar veprimtari bankare dhe/ose financiare, sipas ligjit për bankat.

b) “Ligji për bankat” është ligji nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” dhe/ose çdo ligj ndryshues i tij.

c) “Banka e Shqipërisë” është banka qendrore e Republikës së Shqipërisë, e përcaktuar në nenin 161 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe që funksionon sipas ligjit për Bankën e Shqipërisë.

ç) “Ligji për Bankën e Shqipërisë” është ligji nr. 8269, datë 23.12.1997, i ndryshuar, dhe/ose çdo ligj tjetër ndryshues i tij.

d) “Cash” janë paratë e kredituara në një llogari në çfarëdolloj valute apo pretendime të ngjashme të ripagueshme të parave, të tilla si depozitat monetare.

dh) “Kompensim” (“*netting*”) është konvertimi në një pozicion të vetëm neto, debitues ose kreditues, i të drejtave apo detyrimeve, si rezultat i të cilit vetëm një pozicion përfundimtar neto mund të kërkohej apo të jetë i detyrueshëm; kompensimi është kontraktues dhe mund të jetë dypalësh ose shumëpalësh, me apo pa përtëritje.

e) “Dispozita e kompensimit” (“*close-out*”) është dispozita e kompensimit kontraktues në një marrëveshje të kolateralit financiar apo në një marrëveshje tjetër (kuadër), që përfshin një marrëveshje kolaterali financiar, sipas së cilës, në rast të një situatë ekzekutimi, nëpërmjet kompensimit kontraktues:

i) detyrimet e palëve përshpejtohen, në mënyrë që të jenë të pagueshme menjëherë dhe shprehen si një detyrim për të paguar një sasi që përfaqëson vlerën e tyre aktuale të llogaritur, ose ndërpriten dhe zëvendësohen me një detyrim për të paguar një shumë të tillë të ngjashme; dhe/ose

ii) në një llogari evidentohet detyrimi i palëve ndaj njëra-tjetrës, në lidhje me detyrimet në fjalë, si dhe vlera neto, e barabartë me balancën e llogarisë, që përbën detyrim për t’u paguar nga pala, e cila i detyrohet një shumë më të madhe palës tjetër.

ë) “Kolateral financiar” është *cash-i* dhe instrumentet financiare.

f) “Instrumente financiare” janë aksionet vendase ose të huaja dhe tituj të tjerë të ngjashëm me aksionet, obligacionet dhe format e tjera të instrumenteve të borxhit, nëse këto janë të negociueshme në tregun e kapitalit, tituj të tjerë të cilët normalisht tregtohen dhe që japin të drejtën për të tregtuar aksione, obligacione ose tituj të tjerë nëpërmjet anëtarësimit, blerjes apo këmbimit, ose që japin mundësinë e shlyerjes në para (me përjashtim të instrumenteve të pagesës), duke përfshirë kuotat në shoqëritë e investimeve kolektive, instrumente të tregut të parasë, metale të çmuara të kredituara në një llogari, si dhe pretendime që kanë lidhje me/ose të drejta që rrjedhin nga elementet e sipërcituara.

g) “Marrëveshja e kolateralit financiar” është marrëveshja për transferimin e titullit të pronësisë ose një peng, e cila mund të jetë e rregulluar ose jo nga një marrëveshje kuadër apo nga një marrëveshje tjetër, dhe që zbatohet mbi kolateralin financiar për të siguruar përmbushjen e një detyrimi financiar.

gj) “Marrëveshje për transferimin e titullit të pronësisë” nënkupton marrëveshjen, përfshirë edhe marrëveshjen e riblerjes, që rregullohet nga Ligji Repo, sipas së cilës dhënësi i kolateralit i



transferon marrësit të kolateralit pronësinë e plotë të kolateralit financiar, me qëllim sigurimin ose përmbushjen e detyrimeve të garantuara.

h) “Dhënës kolaterali” është personi juridik që ofron kolateral financiar nëpërmjet një marrëveshjeje për transferimin e titullit të pronësisë ose një pengdhënës.

i) “Marrës kolaterali” është personi juridik që përfiton kolateralin financiar, nëpërmjet një marrëveshjeje për transferimin e titullit të pronësisë së tij, ose një pengmarrës.

j) “Situatë ekzekutimi” është situata e mospërmbushjes së detyrimit ose një situatë tjetër e ngjashme ndërmjet palëve, ndodhja e së cilës i jep të drejtën marrësit të kolateralit financiar që, në bazë të marrëveshjes së kolateralit financiar ose në bazë të legjislacionit, apo kur dispozita e kompensimit “close-out” bëhet efektive, të realizojë kolateralin financiar.

k) “Institucion financiar” është personi juridik, i licencuar për të kryer veprimtaritë financiare në bazë të ligjit për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare dhe/ose në bazë të ligjit për bankat.

l) “Pjesëmarrës” nënkupton Bankën e Shqipërisë, një bankë qendrore të huaj, një bankë, një institucion financiar, një institucion të huaj të ngjashëm me bankat dhe institucionet financiare, një agjent shlyerës, një operator, një autoritet publik, vendas a ndërkombëtar, ose një sistem.

ll) “Nënpjesëmarrës” është personi juridik, i cili ka marrëdhënie kontraktuese me një pjesëmarrës në një sistem që ekzekuton urdhër-transfertat, duke i mundësuar në këtë mënyrë personit juridik kalimin e urdhër-transfertave nëpërmjet sistemit.

m) “Procedura për paaftësi paguese” është çdo procedurë e përcaktuar në ligjet e Republikës së Shqipërisë apo të ndonjë vendi tjetër, me qëllim shpërbërjen e një personi juridik ose riorganizimin e tij, dhe që ka si pasojë, ndër të tjera, pezullimin ose vendosjen e kufizimeve mbi transfertat apo pagesat.

n) “Operator” është personi juridik që, i vetëm ose në bashkëpunim me persona të tjerë juridikë, operon një sistem të licencuar;

nj) “Instrument pagese” është një mjet apo një tërësi procedurash që mundësojnë transferimin e fondeve nga paguesi te përfituesi, ku paguesi dhe përfituesi mund të jenë i njëjti person.

o) “Sistem” është sistemi i pagesave, sistemi për shlyerjen e titujve ose një shtëpi klerimi.

p) “Sistemi i pagesave” është një marrëveshje formale ose një bazë rregullative, e cila është e detyrueshme ndërmjet 3 a më shumë pjesëmarrësish, me rregulla të përbashkëta dhe marrëveshje të standardizuara për ekzekutimin e urdhër-transfertave të *cash*-it ndërmjet pjesëmarrësve.

q) “Sistemi për shlyerjen e titujve” është një marrëveshje formale, e cila është e detyrueshme ndërmjet 3 a më shumë pjesëmarrësve, me rregulla të përbashkëta dhe marrëveshje të standardizuara për ekzekutimin e urdhër-transfertave të instrumenteve financiare ndërmjet pjesëmarrësve.

r) “Shtëpi klerimi” është personi juridik që bën llogaritjen dhe krijimin e pozicioneve neto për pagesat, transfertat e titujve ose marrëveshjet që kanë të bëjnë me transaksionet financiare; për llogaritje dhe/ose pozicione të tilla mund të bazohen në faktin që shtëpia e klerimit është blerës për çdo shitës dhe shitës për çdo blerës në një grup të specifikuar transaksionesh financiare.

rr) “Ligji Repo” është ligji nr. 9974, datë 28.7.2008 “Për kontratën e riblerjes së titujve” dhe/ose çdo ligj ndryshues i tij.

s) “Llogari shlyerjeje” është një llogari e hapur në librat e Bankës së Shqipërisë, ose në librat e llogarive të një agjenti shlyerës, e përdorur për të mbajtur *cash-in* ose instrumente financiare dhe që shërben për të shlyer urdhër-transfertat ndërmjet pjesëmarrësve në një sistem.

sh) “Agjent shlyerës” është personi juridik që u ofron llogari shlyerjeje pjesëmarrësve në sistem, nëpërmjet të cilave shlyhen urdhër-transfertat në sistem dhe që, në raste të veçanta, mund t’u ofrojë kredi pjesëmarrësve për qëllime shlyerjeje.

t) “Urdhër-transferta” është:

i) një udhëzim nga një pjesëmarrës për të vënë në dispozicion të një përfituesi një shumë parash, me anë të regjistrimit në llogari apo transferimit elektronik në llogarinë pranë një banke, një banke qendrore ose një agjenti shlyerës, ose çdo udhëzim që përcakton marrjen përsipër apo kryerjen e një detyrimi, sipas rregullave të sistemit; dhe/ose

ii) një udhëzim nga një pjesëmarrës për të transferuar titullin e pronësisë apo të drejta të tjera mbi instrumentin financiar, nëpërmjet regjistrimit në llogaritë e një regjistri ose ndonjë mënyre tjetër.

th) “*Truncation*” është zëvendësimi i një çeku, kambiali a letre premtimi origjinal me një instrument tjetër ose me një marrëveshje, që ka informacionin e instrumentit fillestar, me ose pa dorëzimin e instrumentit origjinal.

## KREU II RREGULLIMI DHE MBIKËQYRJA E SISTEMEVE

### Neni 6 Licencimi

1. Asnjë person fizik ose juridik nuk mund të operojë një sistem në Shqipëri pa u licencuar nga Banka e Shqipërisë për të operuar këtë sistem, në bazë të këtij ligji.

2. Banka e Shqipërisë vendos kriteret dhe procedurat e nevojshme për licencimin e sistemeve që operojnë në Shqipëri.

3. Në rastin e licencimit të sistemit të shlyerjes së titujve dhe të shtëpisë së klerimit të titujve, subjekti i licencuar nga Banka e Shqipërisë, sipas pikës 1 të këtij neni, fillon ushtrimin e veprimtarisë vetëm pas licencimit nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, sipas kërkesave të legjislacionit të fushës.

### Neni 7 Revokimi ose pezullimi i licencës

1. Banka e Shqipërisë mund të revokojë ose pezullojë licencën e një sistemi, nëse në opinionin e saj:

a) operatori nuk ka filluar veprimtarinë brenda 12 muajve nga data, në të cilën është dhënë licenca;

b) operatori ka pushuar së ushtruari veprimtarinë e tij për një periudhë më të gjatë se 1 muaj;

c) operatori ka marrë licencë për sistemin përmes deklaratave të rreme apo rrugëve të tjera të parregullta;

ç) operatori i sistemit nuk përmbush një ose më shumë nga kriteret e aplikueshme për licencimin;

d) operatori përfshihet në procedurë për paaftësi paguese;

dh) sistemi kërcënon stabilitetin e sistemit financiar në Shqipëri;

e) sistemi nuk është më në interes të publikut ose në interes të pjesëmarrësve.

2. Menjëherë pas marrjes së vendimit për të revokuar ose pezulluar licencën, Banka e Shqipërisë njofton operatorin përkatës dhe publikon një njoftim në mënyrën që e gjykon me të përshtatshme.

### Neni 8 Mbikëqyrja dhe rregullimi i sistemeve

1. Banka e Shqipërisë rregullon dhe mbikëqyr sistemet e licencuara, duke miratuar akte nënligjore për këtë qëllim.



2. Banka e Shqipërisë mund të vendosë standarde dhe kërkesa të tjera shtesë për operatorët, sistemet, pjesëmarrësit dhe nënpjesëmarrësit.

3. Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, me marrëveshje dypalëshe, përcaktojnë rolin e secilit institucion, në lidhje me rregullimin, mbikëqyrjen dhe inspektimin e sistemit të shlyerjes së titujve dhe të shtëpisë së klerimit të titujve.

#### Neni 9

##### **Kompetenca inspektuese e Bankës së Shqipërisë**

1. Me qëllim që të sigurohet dhe të kontrollohet zbatimi i këtij ligji dhe i akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, punonjës të Bankës së Shqipërisë dhe persona të tjerë të kualifikuar, të autorizuar prej saj, mund të inspektojnë mjediset e punës të sistemeve, operatorët, pjesëmarrësit dhe nënpjesëmarrësit, për të kontrolluar llogaritë, regjistrat, dokumentet dhe shkresa të tjera, për të marrë informacion dhe të dhëna prej tyre, si dhe të ndërmarrin veprime të tjera që Banka e Shqipërisë mund t'i vlerësojë të nevojshme.

2. Operatorët, pjesëmarrësit dhe nënpjesëmarrësit vënë në dispozicion të Bankës së Shqipërisë llogaritë, regjistrat, dokumente dhe shkresa të tjera të kërkuara nga ligji e nga aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, operatorët, pjesëmarrësit dhe nënpjesëmarrësit vënë në dispozicion të Bankës së Shqipërisë çdo lloj informacioni dhe të dhëna shtesë, të cilat Banka e Shqipërisë i vlerëson të nevojshme.

#### Neni 10

##### **Kompetenca vendimmarrëse të Bankës së Shqipërisë**

Në përputhje me ligjin për Bankën e Shqipërisë, me ligjet e tjera të fushës dhe aktet e tjera nënligjore, Banka e Shqipërisë mund të nxjerrë urdhra, udhëzime dhe vendime, nëpërmjet të cilave t'u kërkojë sistemeve, operatorëve, pjesëmarrësve dhe nënpjesëmarrësve për të vepruar ose për të mos vepruar, në çfarëdolloj mënyre, që Banka e Shqipërisë e vlerëson të nevojshme ose të këshillueshme.

#### Neni 11

##### **Masa ndëshkimore**

1. Banka e Shqipërisë, në rast shkeljeje të dispozitave të këtij ligji dhe të akteve nënligjore të tij nga operatorët, pjesëmarrësit apo nënpjesëmarrësit, merr masa mbikëqyrëse, masa parandaluese, si dhe urdhëron ndërprerjen e veprimeve në kundërvajtje dhe ndreqjen e pasojave që kanë rrjedhur prej tyre.

2. Banka e Shqipërisë përcakton kushtet e hollësishme dhe metodat për marrjen e masave të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

#### Neni 12

##### **Sanksione administrative**

1. Krahas masave ndëshkimore, të përcaktuara në pikën 1 të nenit 11 të këtij ligji, në rast të shkeljeve të dispozitave të këtij ligji, Banka e Shqipërisë ka të drejtë të vendosë gjoba kundrejt operatorëve, pjesëmarrësve dhe nënpjesëmarrësve.

2. Banka e Shqipërisë gjosit subjektet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni në masën 500 000 (pesëqind mijë) deri në 3 000 000 (tre milionë) lekë, kur konstaton se subjekti:

a) vepron në kundërshtim me pikën 1 të nenit 6 të këtij ligji;

- b) vepron në kundërshtim me pikën 2 të nenit 9 të këtij ligji;
  - c) pengon Bankën e Shqipërisë të kryejë inspektimet, sipas pikës 1 të nenit 9 të këtij ligji;
  - ç) nuk zbaton masat ndëshkimore të përcaktuara nga Banka e Shqipërisë, sipas nenit 11 të këtij ligji;
  - d) vepron në kundërshtim me nenin 15 të këtij ligji;
  - dh) shkel detyrime të tjera të vendosura me këtë ligj.
3. Kur shkeljet e përcaktuara në shkronjat “b” deri në “dh” të pikës 2 të këtij neni përsëriten ose gjoha nuk paguhet brenda afatit dhe, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin “Për kundërvajtjet administrative”, Banka e Shqipërisë vendos dyfishimin e gjobës dhe mund:
- a) të pezullojë licencën e sistemit deri në 6 muaj;
  - b) të revokojë licencën e sistemit.
4. Gjobat e vendosura sipas këtij neni arkëtohen për llogari të Bankës së Shqipërisë.
5. Çdo subjekt i cenuar nga një akt administrativ i Bankës së Shqipërisë ka të drejtë të kërkojë shfuqizimin ose ndryshimin e këtij akti nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë brenda 15 ditëve nga data kur ankuesi ka marrë njoftim për aktin ose nga data e publikimit të tij.

#### Neni 13

##### **Sistemet e Bankës së Shqipërisë**

- 1. Ky kre nuk zbatohet për sistemet në pronësi dhe/ose që operohen nga Banka e Shqipërisë.
- 2. Pavarësisht nga paragrafi i mësipërm, sistemet në pronësi dhe/ose që operohen nga Banka e Shqipërisë duhet të jenë në përputhje me rregullat e mbikëqyrjes, të miratuara nga Banka e Shqipërisë, të cilat zbatohen për sisteme të ngjashme të licencuara.

#### Neni 14

##### **Lista e sistemeve**

- 1. Banka e Shqipërisë publikon dhe administron listën e sistemeve dhe operatoreve të licencuar që mbikëqyren prej saj.
- 2. Lista e sistemeve përditësohet pas çdo ndryshimi që ndodh sipas pikës 1 të nenit 6 dhe pikës 2 të nenit 7 të këtij ligji.

#### Neni 15

##### **Rregullimi dhe mbikëqyrja e instrumenteve të pagesave**

- 1. Banka e Shqipërisë mund të rregullojë dhe të mbikëqyrë emetimin dhe përdorimin e instrumenteve të pagesave, si pjesë e sistemit kombëtar të pagesave, me qëllim që të garantojë sigurinë, mirëfunksionimin dhe efikasitetin e tyre.
- 2. Dispozitat e ligjit zbatohen edhe për aspekte të rregullimit dhe mbikëqyrjes së instrumenteve të pagesave, aty ku është e përshtatshme.

#### Neni 16

##### **Nënpjesëmarrësi**

Në raste të riskut sistemik dhe me kusht që nënpjesëmarrësi të jetë i njohur në sistem, Banka e Shqipërisë mund të vendosë që, për qëllime të këtij ligji, nënpjesëmarrësi të konsiderohet si pjesëmarrës në një sistem të veçantë.



### KREU III MBROJTJA E SISTEMEVE

#### Neni 17

#### **Procedura për paaftësi paguese**

1. Procedura për paaftësi paguese nuk ka efekt prapaveprues mbi të drejtat dhe detyrimet e pjesëmarrësit, që rrjedhin nga ose kanë lidhje me pjesëmarrjen e tij në një sistem, përpara çastit të hapjes së një procedure të tillë.

2. Në zbatim të këtij ligji, çasti i hapjes së procedurës për paaftësi paguese kundrejt një pjesëmarrësi në një sistem është ai kur:

a) operatori i sistemit njoftohet nga Banka e Shqipërisë për hapjen e procedurave të tilla, sipas pikës 2 të nenit 21 të këtij ligji; dhe

b) në rastet kur Banka e Shqipërisë operon vetë sistemin:

i) Banka e Shqipërisë është njoftuar nga kancelari, sipas pikës 1 të nenit 21 të këtij ligji; ose

ii) Banka e Shqipërisë merr vendim për vendosjen e një banke në kujdestari apo në likuidim të detyruar.

#### Neni 18

#### **Karakter i përfundimtar i pagesës, klerimit dhe shlyerjes**

1. Janë të vlefshme, të ekzekutueshme dhe të detyrueshme ndaj palëve të treta, përfshirë likuidatorin dhe kujdestarin, dhe nuk mund të kundërshtohen në asnjë mënyrë:

a) urdhër-transferta, pagesa e *cash*-it dhe transferata e instrumenteve financiare që rezultojnë nga urdhër-transferta e tillë, në rastet kur ajo ka hyrë në sistem, në përputhje me rregullat e tij, përpara çastit të hapjes së procedurës për paaftësi paguese, pavarësisht nëse ajo është shlyer përpara, ose pas çastit të hapjes së procedurës për paaftësi paguese; dhe

b) kompensimi i urdhër-transferatave dhe i pretendimeve e detyrimeve që rezultojnë nga të tilla urdhër-transferta, në rastet kur ato kanë hyrë në sistem, në përputhje me rregullat e tij, përpara çastit të hapjes së procedurës për paaftësi paguese, pavarësisht nëse kompensimi është kryer përpara ose pas çastit të hapjes së procedurës për paaftësi paguese.

2. Çasti i hyrjes së urdhër-transferatës në sistem përcaktohet në rregullat e këtij sistemi.

3. Kompensimi i pretendimeve dhe detyrimeve brenda një shtëpie klerimi është i vlefshëm, i ekzekutueshëm dhe i detyrueshëm ndaj palëve të treta, përfshirë likuidatorin dhe kujdestarin, dhe nuk mund të kundërshtohet në asnjë mënyrë, në rastet kur pretendimet dhe detyrimet që do të kompensohen u janë njoftuar shtëpive të klerimit përpara çastit të hapjes së procedurës për paaftësi paguese, pavarësisht nëse kompensimi ose pagesa apo shlyerja neto e pretendimeve dhe detyrimeve është kryer përpara ose pas çastit të hapjes së procedurës për paaftësi paguese.

#### Neni 19

#### **Parevokueshmëria e urdhër-transferatës**

Urdhër-transferta e futur në sistem, duke filluar nga çasti i përcaktuar nga rregullat e këtij sistemi, nuk mund të revokohet nga një pjesëmarrës i sistemit, apo nga cilado palë e tretë, përfshirë likuidatorin ose kujdestarin.

Neni 20

**Shlyerja pas procedurës për paaftësi paguese**

Pavarësisht hapjes së procedurës për paaftësi paguese ndaj një pjesëmarrësi në një sistem dhe në bazë të neneve 17 e 18 të këtij ligji, operatori ose agjenti shlyerës i një sistemi, nëse i lejohet, në bazë të dispozitave kontraktuese të zbatueshme, mund:

a) të përdorë *cash*-in dhe instrumentet financiare të disponueshme në llogarinë shlyerëse të pjesëmarrësit për të shlyer urdhër-transfertat e mbetura pezull, si dhe çdo balancë neto debitore që pjesëmarrësi mund t'i detyrohet pas kompensimit, duke lejuar kështu shlyerjen përfundimtare brenda sistemit;

b) të ofrojë linjë kredie për pjesëmarrësin dhe të realizojë çdo kolateral të ofruar, me qëllim që të garantojë linjën e kredisë.

Neni 21

**Njoftimi për hapjen e procedurës për paaftësi paguese**

1. Kancelari i gjykatës, që kryen fillimin e procedurës për paaftësi paguese kundër një operatori ose pjesëmarrësi, i siguron menjëherë Bankës së Shqipërisë një kopje të aktit përkatës të gjykatës.

2. Banka e Shqipërisë njofton menjëherë operatorët e sistemeve për fillimin e procedurës për paaftësi paguese kundër një operatori, pjesëmarrësi ose nënpjesëmarrësi.

3. Në rast se Banka e Shqipërisë njoftohet nga autoritetet e huaja që ka filluar procedura për paaftësi paguese kundrejt ndonjë sistemi, operatori ose pjesëmarrësi të huaj, ajo informon menjëherë operatorët e sistemeve.

Neni 22

**Mbrojtja e llogarisë shlyerëse**

Balanca e *cash*-it dhe e instrumenteve financiare të kredituara në llogarinë shlyerëse nuk janë objekt i procedurave të ekzekutimit të detyrueshëm, me përjashtim të rastit kur procedura e ekzekutimit të detyrueshëm fillohet nga operatori ose agjenti shlyerës i sistemit.

Neni 23

**Ligji i zbatueshëm**

1. Procedura për paaftësinë paguese, e filluar kundrejt një pjesëmarrësi të huaj në një sistem që operohet nga Banka e Shqipërisë, ose në një sistem që është i licencuar prej saj, sipas këtij ligji, rregullohet tërësisht dhe ekskluzivisht nga legjislacioni i Republikës së Shqipërisë.

2. Procedura për paaftësinë paguese, e filluar kundrejt një pjesëmarrësi shqiptar në një sistem të huaj, rregullohet tërësisht dhe ekskluzivisht nga legjislacioni i vendit që rregullon atë sistem të huaj.

**KREU IV**

**MARRËVESHJA E KOLATERALIT FINANCIAR**

Neni 24

**Fusha e zbatimit të këtij kreu**

1. Dispozitat e këtij kreu zbatohen për të gjitha marrëveshjet e kolateralit financiar të lidhura ndërmjet personave juridikë, ku, të paktën, njëra nga palët është Republika e Shqipërisë,



Banka e Shqipërisë, një bankë qendrore e huaj, një bankë, një institucion financiar, një institucion i huaj i ngjashëm me bankat dhe institucionet financiare, një agjent shlyerës, një operator ose një autoritet publik vendas apo ndërkombëtar.

2. Marrëveshja e kolateralit financiar mund të sigurojë të gjitha llojet e detyrimeve financiare, përfshirë ato të tanishme ose të ardhme, ato aktuale ose të kushtëzuara apo të mundshme, që dhënësi i kolateralit apo cildo person tjetër i detyrohet marrësit të kolateralit ose përfaqësuesit të tij të autorizuar.

#### Neni 25

##### **Vlefshmëria dhe njohja e marrëveshjes së kolateralit financiar**

Marrëveshja e kolateralit financiar është e vlefshme, e përfunduar dhe nuk mund të kundërshtohet nga palët e treta, përfshirë likuidatorin dhe kujdestarin, si dhe mund të zbatohet/ekzekutohet në përputhje me dispozitat e saj, me kusht që:

a) marrëveshja të mund të provohet me shkrim ose në formë elektronike, apo me mënyra të tjera të ngjashme të njohura ligjërisht;

b) posedimi i instrumenteve financiare, objekt i marrëveshjes së kolateralit financiar, të transferohet te marrësi i kolateralit, kusht i cili quhet i përmbushur nëse instrumentet financiare:

i) dorëzohen fizikisht te marrësi i kolateralit ose te një person që vepron në emër të tij;

ii) mbahen, transferohen ose janë objekt i ndonjë mase, në mënyrë të tillë që marrësi i kolateralit apo një person që vepron në emër të tij i posedon ose i kontrollon. Ky transferim i posedimit të instrumenteve financiare mund të arrihet edhe me anë të kreditimit të tyre në një llogari speciale, të mbajtur në një regjistër, në emër të dhënësit të kolateralit, marrësit të kolateralit ose një pale të tretë, që vepron si depozitues; dhe/ose

c) posedimi i *cash*-it, objekt i marrëveshjes së kolateralit financiar, të transferohet te marrësi i kolateralit, kusht i cili quhet i përmbushur nëse *cash*-i transferohet në një llogari të veçantë, mbahet, transferohet ose është objekt i ndonjë mase në mënyrë të tillë që marrësi i kolateralit apo një person që vepron në emër të tij të posedojë ose të ketë kontrollin mbi *cash*-in. Marrësi i kolateralit njofton debitorin për transferimin e kryer, duke i bërë të ditur pretendimin mbi *cash*-in ose detyrimin e debitorit për të njohur shprehimisht ekzistencën e marrëveshjes së kolateralit financiar.

#### Neni 26

##### **Vlefshmëria dhe njohja e dispozitës së kompensimit “close-out”**

Dispozita e kompensimit “close-out” është e vlefshme, nuk mund të kundërshtohet nga palët e treta dhe merr efekt menjëherë, pa njoftim paraprak ose pa vendim të ndonjë gjykate, ose veprim tjetër të ndonjë organi apo nëpunësi publik, në përputhje me kushtet e saj:

a) pavarësisht hapjes së procedurës së paaftësisë paguese kundër dhënësit të kolateralit, debitorit, marrësit të kolateralit ose kreditorit;

b) pavarësisht ndonjë mase sigurimi, sekuestroje ose urdhri apo vendimi tjetër të ngjashëm gjyqësor, përmbarimor ose të çdo organi tjetër, në lidhje me të drejtat dhe detyrimet për kolateralet që janë subjekt i kësaj dispozite.

#### Neni 27

##### **Mbrojtja e zëvendësimit dhe dorëzimi i kolateralit shtesë**

1. Marrëveshja e kolateralit financiar mund të përmbajë:

a) detyrimin për të ofruar kolateral financiar ose kolateral financiar shtesë, në mënyrë që të mbulohen ndryshimet në vlerën e kolateralit financiar ose të shumës së detyrimeve të garantuara;

b) të drejtën për të tërhequr kolateral financiar, duke siguruar, nëpërmjet zëvendësimit ose shkëmbimit, kolateral financiar në përmbajtje me të njëjtën vlerë.

2. Dorëzimi i kolateralit financiar në bazë të detyrimit ose të së drejtës, të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, është i vlefshëm, i pakundërshtueshëm nga palët e treta, përfshirë likuidatorin dhe kujdestarin, edhe në ato raste kur dorëzimi është bërë në ditën e hapjes së procedurës për paaftësi paguese, me kusht që marrësi i kolateralit të provojë se nuk ishte ose nuk mund të ishte në dijeni të hapjes së procedurës.

3. Dorëzimi i kolateralit financiar në bazë të detyrimit ose të së drejtës, të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, nuk përbën një marrëveshje të re ndërmjet palëve.

#### Neni 28

##### **Realizimi i kolateralit financiar të lënë peng**

1. Pavarësisht hapjes së procedurës për paaftësi paguese kundrejt pengmarrësit ose pengdhënësit, në rast të një situatë ekzekutimi, pengmarrësi ka të drejtë të realizojë menjëherë, pa njoftim paraprak dhe pa ndërhyrjen e gjykatës a të ndonjë organi ose nëpunësi publik, apo çdo personi tjetër, çdo kolateral financiar të dhënë sipas kushteve të rëna dakord në peng.

2. Në rast se kolaterali financiar ka për objekt:

a) instrument financiar, realizimi i tij bëhet nëpërmjet shitjes ose përvetësimit dhe, më pas, duke e përdorur vlerën e marrë për përmbushjen e detyrimeve të garantuara;

b) *cash-in*, realizimi i tij bëhet duke e përdorur atë për përmbushjen e vlerës së detyrimeve të garantuara.

#### Neni 29

##### **Radha e preferencës së të drejtave mbi pengun**

Të drejtat e pengmarrësit mbi kolateralin financiar të lënë peng mbizotërojnë mbi të drejtat e çdo kreditori tjetër të pengdhënësit.

#### Neni 30

##### **Efekti joprapaveprues i procedurës për paaftësi paguese mbi dhënien e kolateralit financiar**

Dhënia e kolateralit financiar nuk mund të deklarohet e pavlefshme, nul, ose të anulohet, me kusht që kolaterali financiar të jetë dorëzuar jo më vonë se ditën e hapjes së procedurës për paaftësi paguese dhe marrësi i kolateralit të provojë se nuk ishte ose nuk mund të ishte në dijeni për hapjen e procedurës.

#### Neni 31

##### **Titujt e dematerializuar**

1. Në lidhje me titujt e dematerializuar, legjislacioni i vendit ku mbahet llogaria përkatëse rregullon edhe çështjet e mëposhtme:

a) natyrën ligjore dhe efektet e pronësisë së titujve;

b) kërkesat për përfundimin e një marrëveshjeje të kolateralit financiar për titujt, dhënien e këtyre titujve, sipas një marrëveshjeje të tillë dhe, në përgjithësi, përmbushjen e hapave të nevojshëm për të bërë efektive një marrëveshje dhe dhënie të tillë ndaj palëve të treta;

c) nëse e drejta e pronësisë ose ndonjë e drejtë tjetër apo interes i një personi mbi titujt mbizotëron ose varet nga një e drejtë pronësie apo e drejtë tjetër, ose nëse ka ndodhur një blerje në mirëbesim;



ç) hapat e nevojshëm që kërkohen për realizimin e titujve të dhënë si kolateral financiar, sipas një marrëveshjeje kolaterali financiar, në rast se ndodh një situatë ekzekutimi.

2. Titujt e dematerializuar janë instrumente financiare, ku të drejtat mbi to evidentohen në një zë të veçantë në regjistër ose në një llogari që mbahet nga ose në emër të një ndërmjetësi.

3. Llogaria ku mbahen titujt e dematerializuar është regjistri ose llogaria, në të cilën kryhen regjistrimet e titujve për llogari të zotëruesit të tyre. Kjo llogari mund të mbahet nga marrësi i kolateralit.

4. Referimi në legjislacionin e një vendi është referim në të drejtën e tij të brendshme, duke përjashtuar çdo rregull të mundshëm, sipas të cilit vendimmarrja për çështje të caktuara mund të bëhet duke iu referuar legjislacionit të një vendi tjetër.

## KREU V PROVAT

### Neni 32

#### **Pranueshmëria e provës elektronike dhe optike**

Ekzistenca, përmbajtja, afati i çdo urdhër-transferete, hyrja e tij në një sistem, si dhe ekzekutimi i tij mund të vërtetohen në të gjitha çështjet, qofshin ato civile, penale ose administrative, kundrejt pjesëmarrësit ose ndonjë pale të tretë, me shkrim ose me mjete të qëndrueshme, që sigurojnë gjurmimin e tij, qoftë në formë optike ose elektronike, duke përfshirë kopje të printuara të dokumenteve të tilla elektronike ose optike.

### Neni 33

#### **Procedura “truncation”**

Banka e Shqipërisë, nëpërmjet akteve nënligjore, mund të organizojë procedurën “truncation” të instrumenteve të pagesave, duke përcaktuar edhe pasojat e kësaj procedure për pjesëmarrësit dhe sistemet e përfshira në procesimin e këtyre instrumenteve.

## KREU VI DISPOZITA TË FUNDIT

### Neni 34

#### **Efekte mbi dispozita ligjore**

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, pika 5 e nenit 116 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, shfuqizohet.

### Neni 35

#### **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 29.4.2013

**Shpallur me dekretin nr. 8166, datë 13.5.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bujar Nishani**

**LIGJ**  
**Nr. 134/2013**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË KREDISË SË EKSPORTIT NDËRMJET  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE, DHE  
ERSTE BANK DER OESTERREICHISCHEN SPARKASSEN AG PËR PROJEKTIN E  
TATIMIT ELEKTRONIK (E-TAXATION)**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e  
Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Ratifikohet marrëveshja e kredisë së eksportit ndërmjet Republikës së Shqipërisë,  
përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Erste Bank Der Oesterreichischen Sparkassen AG për  
projektin e tatimit elektronik (E-Taxation).

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 29.4.2013

**Shpallur me dekretin nr. 8167, datë 13.5.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bujar Nishani**

**MARRËVESHJE KREDIE EKSPORTI**

**E LIDHUR NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E  
FINANCAVE (MË POSHTË QUHET “HUAMARRËSI”) DHE ERSTE BANK DER  
OESTERREICHISCHEN SPARKASSEN AG (MË POSHTË QUHET “HUADHËNËSI”) PËR  
PROJEKTIN “TATIMI ELEKTRONIK”**

**HYRJE**

**Ndërsa:**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe  
Qeveria e Republikës së Austrisë, e përfaqësuar nga Ministri Federal i Financave, përfunduan një  
marrëveshje për bashkëpunimin financiar në datën 7.12.2010.

Më 16.1.2013, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Shqipëri (më poshtë quhet “Blerësi i  
projektit”) Qualysoft Ressource und Entwicklung für Informationstechnologie GmbH and WedoIT-  
solutions GmbH, Austria (më poshtë quhet “eksportues të projektit”) kanë lidhur një kontratë  
furnizimi për dhënien e një sistemi tatimor elektronik, lokalizimin, zbatimin në shumën prej  
10,312,000.00 eurosh (më poshtë quhet “kontrata e dhënies së projektit”).



Oesterreichische Kontrollbank Aktiengesellschaft (më poshtë quhet “OeKB”) është autorizuar nga autoritetet kompetente të premtojë financimin e projektit me terma koncesionalë sipas Konsensusit të OECD-së me një nivel koncesionaliteti prej 35.30%, duke rifinancuar huan e butë të dhënë nga Huadhënësi.

Huadhënësi ka rënë dakord të paraqesë një hua të butë për financimin e 100% të vlerës së kontratës së dhënies së projektit të mbuluar nga një garanci e EoKB-së në emër të Republikës së Austrisë me termat dhe duke iu nënshtruar kushteve të kësaj marrëveshjeje.

Në marrjen përsipër të këtyre detyrimeve, Huamarrësi vepron si i detyruari kryesor dhe primar kundrejt Huadhënësit, dhe jo si agjent.

Kjo marrëveshje dhe marrëveshja e dhënies së projektit janë marrëveshje të veçanta dhe të pavarura. Asnjë mospërbushje nga eksportuesit e projektit ose Blerësi i projektit për përmbushjen e detyrimeve sipas marrëveshjes së dhënies së projektit nuk ndikon mbi detyrimet e Huamarrësit kundrejt Huadhënësit, dhe Huadhënësi nuk është përgjegjës për asnjë mosveprim të eksportuesit të projektit ose Blerësit të projektit.

Kështu bihet dakord si më poshtë:

#### PËRKUFIZIME

Në këtë marrëveshje dhe në anekset e saj, shprehjet e mëposhtme kanë kuptimet e mëposhtme:

“Protokoll i pranimit për testin e regresit” është protokollin ose certifikata e pranimit nëpërmjet të drejtave në lidhje me 5% e fundit të çmimit të projektit sipas kontratës së dhënies së projektit.

“Marrëveshje” është marrëveshje e kredisë së eksportit.

“Aneks” është një dokument i bashkëngjitur kësaj marrëveshjeje, ku termat e tij konsiderohen të jenë përfshirë në këtë marrëveshje dhe përbëjnë pjesë të saj.

“Nen” do të thotë një nen i kësaj marrëveshjeje.

“Periudhë e disponibilitetit” është periudha gjatë së cilës mund të bëhen tërheqje sipas instrumentit të kredisë, që fillon në datën e hyrjes në fuqi deri 20 (njëzet) muaj më vonë.

“Huamarrës” është Republika e Shqipërisë e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr. 4, Tiranë, Shqipëri.

“Huamarrje” është një transh i instrumentit të kredisë i livruar ose që do të livrohet në pajtim me procedurën e pagesës.

“Ditë pune” është një ditë (e ndryshme nga e shtuna ose e diela) në të cilën bankat janë të hapura për aktivitet të zakonshëm në Vjenë dhe në Tiranë dhe që është, gjithashtu, një ditë target. Për mënyrën e dyshimit, nëse në këtë marrëveshje bëhet referencë te “ditët”, kjo është një referencë në ditët kalendarike.

“Tarifa e angazhimit” është tarifa e përkufizuar në nenin 3.1.

“Kredia” është shuma e kredisë prej deri në 10.312.000,00 euro sipas përcaktimit në nenin 1.1.

“Data e hyrjes në fuqi” është data e përkufizuar në nenin 6.

“EUR” ose “euro” është monedha e vetme e shteteve anëtare të Bashkimit Europian, që kanë miratuar euron si monedhën e tyre në pajtim me legjislacionin e EMU-së.

“Ngjarje e qenies në vonesë” është një ngjarje ose rrethanë e specifikuar në këtë nen 7.

“Llogaria” është llogaria e hapur në emër të Huamarrësit në pajtim me dispozitat e nenit 1.2.

“Data përfundimtare e hyrjes në fuqi” është data e përkufizuar në nenin 6.

“Huadhënës” është Erste Bank der Oesterreichischen Sparkassen AG, Graben 21, 1010 Vienna, Austria, e regjistruar në Gjykatën Tregtare të Vjenës, me nr. regjistrimi 286283f.

“Hua” do të thotë shuma e përgjithshme principale e huamarrjeve të livruara sipas instrumentit të kredisë dhe për kohën e mbetur.

“Tarifa e menaxhimit” është tarifa e përkufizuar në nenin 3.2.

“Efekt i konsiderueshëm negativ” është një referencë të diçka që, sipas mendimit të arsyeshëm të huadhënësit, mund të ketë një efekt të konsiderueshëm negativ për: i) gjendjen financiare të huamarrësit; ose ii) aftësinë e Huamarrësit për të përmbushur një nga detyrimet sipas marrëveshjes nëse një detyrim i tillë bëhet i kërkueshëm; ose iii) aftësinë e Huadhënësit për të ushtruar ose ekzekutuar një të drejtë sipas marrëveshjes.

“OeKB” është Oesterreichische Kontrollbank Aktiengesellschaft, Am Hof 4, A-1011 Vienna, Austria.

“Garanci e OeKB-së” është një garanci eksporti e dhënë ose që do të jepet nga OeKB-ja në lidhje me marrëveshjen në emër të Republikës së Austrisë në pajtim me ligjin e nxitjes së eksportit 1981, i ndryshuar.

“Marrëveshje rifinancimi e OeKB-së” është një marrëveshje rifinancimi e përfunduar ndërmjet OeKB-së dhe Huadhënësit në lidhje me marrëveshjen për 100% të instrumentit të kredisë.

“Procedurë pagese” është procedura për pagesën e huamarrjeve të specifikuar në aneksin 1.

“Projekti” është furnizimi, lokalizimi dhe zbatimi i një sistemi tatimor elektronik (duke përfshirë dhënien e pjesëve fizike dhe një produkt programi COTS).

“Blerës i projektit” është Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Rr. “Gjin Bue Shpata”, Tiranë, Shqipëri.

“Kontratë e dhënies së projektit” është kontrata e furnizimit për dhënien e një sistemi tatimor elektronik, lokalizimi, zbatimi në shumën prej 10.312.000,00 eurosh e lidhur më 16.1.2013 ndërmjet Blerësit të projektit dhe eksportuesve të projektit në lidhje me projektin dhe duke përfshirë çdo shtesë pasuese dhe/ose ndryshimet në të, sipas rastit.

“Eksportues të projektit” janë Qualysoft Ressource und Entwicklung für Informationstechnologie GmbH, SaturnTower, Leonard-Bernstein-Straße 10, 1220 Vienna, Austria (më poshtë quhet edhe “Qualysoft”) dhe wedoIT-solutions GmbH, Seidlgasse 21/1/11, 1030 Vienna, Austria (më poshtë quhet edhe “wedoIT-solutions”).

“Mjet i sigurimit të padisë” është hipoteka, pengu, barra, kalimi ose transferimi për qëllime garancie, hipotekimi, mbajtja e titullit ose një mjet tjetër siguri të padisë që siguron një detyrim të një personi ose një marrëveshje tjetër, e drejtë preferenciale ose masë që ka efekt të ngjashëm.

“Data e nënshkrimit” është data në të cilën marrëveshja nënshkruhet nga Huamarrësi dhe Huadhënësi.

“Pika e fillimit” është data e protokollit të pranimit për testin e regresionit.

“TARGET2” është sistemi i pagesës Trans-European Automated Real-time Gross Settlement Express Transfer që përdor një platformë të vetme të përbashkët që ka filluar më 19 nëntor 2007.

“Ditë target” është një ditë në të cilën target 2 është i hapur për rregullimin e pagesave në euro.

“Tatim/tatime” është çdo tatim, detyrim, tarifë pulle, zbritje ose mbajtje apo detyrime të tjera të një natyre të ngjashme (duke përfshirë, pa kufizim, çdo gjëbë ose interes të pagueshëm në lidhje me një mospagesë ose vonesë në pagesën e tyre) dhe “tatime” “tatim” interpretohet përkatësisht.

## 1. INSTRUMENTI I KREDISË DHE LLOGARIA E INSTRUMENTIT

### 1.1 Instrumenti i kredisë

Huadhënësi bie dakord t’i ofrojë Huamarrësit një instrument kredie prej deri në 10.312.000,00 euro (në fjalë: dhjetë milionë e treqind e dymbëdhjetë mijë/00) sipas termave dhe kushteve të parashikuar në këtë marrëveshje, me kusht që:

i) pagesat bëhen drejtpërdrejt te Qualysoft (që është marrësi i pagesave për eksportuesit e projektit dhe kontratën e dhënies së projektit) në pajtim me procedurën e pagesës së specifikuar në aneksin 1 dhe bëhen në një ditë pune brenda periudhës së disponibilitetit dhe zbatohen kundrejt



pagesës së çmimit të kërkueshëm për eksportuesit e projektit sipas kontratës së dhënies së projektit. Huadhënësi, megjithatë, nuk është i detyruar të monitorojë ose të verifikojë përdorimin e huas. Çdo livrim të Qualysoft nga Huadhënësi përbën një hua dhe detyron Huadhënësin të debitojë llogarinë e instrumentit me të njëjtën shumë;

ii) shumën e plotë të tërheqjeve nuk e kalon instrumentin e kredisë;

iii) Huadhënësi nuk bën asnjë pagesë pas fundit të periudhës së disponibilitetit.

#### 1.2 Llogaria e instrumentit

Huadhënësi hap një llogari instrumenti në euro në emrin e Huamarrësit, të përcaktuar si “Llogaria e instrumentit, projekti i tatimit elektronik”. Çdo tërheqje debitohet në llogarinë e instrumentit në vlerën dhe datën e pagesës së kësaj tërheqjeje nga Huadhënësi dhe Huadhënësi informon Huamarrësin me e-mail ose faks.

### 2. INTERESI

#### 2.1 Interesi për llogarinë e instrumentit

Me përjashtim të një interesi të munguar që është i pagueshëm në pajtim me nenin 2.2, asnjë interes nuk është i pagueshëm për shumën e huas që është herë pas here i prapambetur në llogarinë e instrumentit.

#### 2.2 Interesi i munguar

Në rastin e moskryerjes nga Huamarrësi të pagesave në datën e kërkueshme të një shume të kërkueshme, Huamarrësi paguan interes për këtë shumë nga data e moskryerjes deri në datën e pagesës faktike me një normë prej 2% (në fjalë: dy për qind) në vit.

Interesi i munguar i kërkueshëm në pajtim me këtë nen mbledhet nga dita në ditë, llogaritet mbi bazën e numrit faktik të ditëve të kaluara dhe një viti me 360 ditë dhe paguhet në fund të çdo semestri nga Huamarrësi Huadhënësit më 31 mars, 30 qershor, 30 shtator dhe 31 dhjetor në çdo vit.

### 3. TARIFA DHE SHPENZIME

Detyrimet e Huamarrësit sipas këtij neni 3 mbeten në fuqi të plotë pavarësisht nga livrimi faktik i huas dhe mbetet në fuqi pas çdo shlyerjeje të parakohshme ose një anulimi apo zgjidhjeje të kësaj kontrate.

#### 3.1 Tarifa e përkushtimit

Nga data e hyrjes në fuqi, Huamarrësi, deri në fund të periudhës së disponibilitetit, i paguan Huadhënësit një tarifë përkushtimi (tarifa e përkushtimit) me një normë prej 0,65% (zero pikë gjashtëdhjetë e pesë për qind) në vit.

Tarifa e përkushtimit llogaritet mbi bazën e balancës së patërhequr të instrumentit të kredisë në fillim të çdo semestri kalendarik dhe të numrit faktik të ditëve të kaluara dhe një viti me 360 ditë dhe paguhet në fund të çdo semestri nga Huamarrësi Huadhënësit më 31 mars, 30 qershor, 30 shtator dhe 31 dhjetor në çdo vit. Pagesa e parë e tarifës së përkushtimit bëhet në ditën e fundit të semestrit kalendarik pas datës së hyrjes në fuqi.

#### 3.2 Tarifa e menaxhimit

Huamarrësi, brenda 14 ditëve pas ditës së hyrjes në fuqi, i paguan Huadhënësit një tarifë menaxhimi (tarifa e menaxhimit prej 0,7% (zero pikë shtatë për qind) të sheshtë mbi instrumentin e kredisë që është 72.184,00 euro. Për mënjanimin e dyshimit, pagesa e tarifës së menaxhimit duhet të bëhet para se të bëhet tërheqja e parë. Huadhënësi informon Huamarrësin për ndodhinë e datës së hyrjes në fuqi dhe për detyrimin për të paguar tarifën e menaxhimit.

#### 3.3 Detyrimet e garancive të OeKB-së

Ministria Federale e Financave të Republikës së Austrisë jep një grand në shumën prej 761.250,00 eurosh mbi detyrimet e garancisë së OeKB-së. Pas zbritjes së këtij grand, OeKB-ja vendos për garancinë e OeKB-së një normë fikse në vit prej 1% (detyrimet e garancisë së OeKB-së) mbi shumën e instrumentit të kredisë.

Huamarrësi i paguan Huadhënësit detyrimet e garancisë së OeKB-së në pajtim me vendosjen e OeKB-së.

Llogaritja e OeKB-së të detyrimeve të garancive të OeKB-së bëhet mbështetur në prezumimin e një huaje gjithnjë në rritje gjatë periudhës së disponibilitetit dhe grafikut të parashikuar të shlyerjes. Për më tepër, llogaritja e OeKB-së bazohet në numrin faktik të ditëve të kaluara (duke prezumuar çdo muaj me 30 ditë) dhe një vit me 360 ditë. Detyrimet e garancisë së OeKB-së janë të pagueshme në fund të çdo semestri më 31 mars, 30 qershor, 30 shtator dhe 31 dhjetor të çdo viti.

Data e kërkueshme për pagesën e parë të detyrimeve të garancisë së OeKB-së dhe norma dhe shumat e sakta përcaktohen nga OeKB-ja bazuar në efektshmërinë e garancisë së OeKB-së. Huadhënësi informon Huamarrësin në lidhje me grafikun e pagesës së OeKB-së për detyrimet e garancisë së OeKB-së pas marrjes nga OeKB-ja.

Në rastin e shmangies nga periudha e parashikuar për tërheqjen dhe grafikun e shlyerjes, që rezulton në një risk më të lartë (p.sh., duke shtyrë afatin e parashikuar të huas), OeKB-ja rillogarit përkatësisht detyrimet e garancisë së OeKB-së. Huamarrësi zhdëmton Huadhënësin për çdo rritje të detyrimeve të OeKB-së të shkaktuar nga kjo shmangie.

### 3.4 Shpenzimet

Huamarrësi paguan çdo detyrim pulle apo regjistrimi, ose taksë të ngjashme apo detyrim, ose taksë dokumentacioni apo çdo akcizë ose taksë pasurie tjetër, detyrime ose tarifa të ngjashme jashtë Austrisë, sipas rastit, që rrjedhin nga një pagesë e bërë sipas kësaj marrëveshjeje ose nga nënshkrimi, dhënia ose regjistrimi apo tjetër në lidhje me këtë marrëveshje dhe herë pas here me kërkesën e Huadhënësit e zhdëmton Huadhënësin ndaj çdo detyrimi, shpenzimi, pretendimi ose kostoje që rrjedh nga mospagesa apo vonesa në pagesën e këtij tatimi ose detyrimi.

Huamarrësi i paguan Huadhënësit me kërkesë të tij të gjitha kostot dhe shpenzimet (duke përfshirë, por pa u kufizuar, në tarifat ligjore dhe shpenzimet e udhëtimit) të pësura nga Huadhënësi: i) në negociimin, përgatitjen dhe përfundimin e kësaj marrëveshjeje; ii) në ruajtjen, mbrojtjen dhe ekzekutimin e çdo të drejte sipas kësaj marrëveshjeje; dhe iii) në lidhje me një ndryshim, heqje dorë, pëlqim ose pezullim të drejtash të kërkuara në emër të Huamarrësit. Huadhënësi i jep Huamarrësit prova të arsyeshme për këto shpenzime.

### 3.5 Shpenzimet e shtuara

Huamarrësi i paguan Huadhënësit menjëherë me kërkesë të Huadhënësit shumën e shpenzimeve të shtuara të shkaktuara nga Huadhënësi si rezultat: i) i prezantimit të një ndryshimi (ose në interpretimin ose administrimin apo zbatimin) të një ligji, rregulloreje, kërkesë, direktive ose kërkesë; ose ii) i respektimit të një ligji, rregulloreje, kërkesë, direktive ose kërkesë të bërë, hyrë në fuqi, vendosur ose zbatuar pas datës së nënshkrimit; ose iii) i respektimit të një kërkesë për mjaftueshmërinë e kapitalit ose një kërkesë tjetër të një banke qendrore përkatëse apo autoritet tjetër fiskal, monetar ose tjetër përgjithësisht e zbatueshme për institucionet financiare dhe/ose bankat.

Në këtë marrëveshje “shpenzime të shtuara” janë: i) shpenzime shtesë ose të shtuara; ii) zbritja në normën e të arkëtuarave nga instrumenti sipas kësaj marrëveshjeje ose në kapitalin e përgjithshëm të Huadhënësit; ose iii) zbritja e një shume të kërkueshme dhe të pagueshme sipas kësaj marrëveshjeje, që pësohet nga Huadhënësi në masën që i atribuohet marrjes përsipër të detyrimit nga Huadhënësi sipas kësaj marrëveshjeje ose financimit apo përmbushjes së këtyre detyrimeve sipas kësaj marrëveshjeje. Një certifikatë në lidhje me shumën e këtyre shpenzimeve të shtuara, që i paraqitet Huamarrësit nga Huadhënësit, përbën provë konkludente për këto shpenzime të shtuara.

## 4. SHLYERJA

### 4.1 Shlyerja

Huaja e dhënë shlyhet nga Huamarrësi me 19 (nëntëmbëdhjetë) kështe të njëpasnjëshme gjysmëvjetore shlyerjeje. Kësti i parë i shlyerjes është i kërkueshëm 72 (shtatëdhjetë e dy) muaj pas pikës së fillimit, por në çdo rast jo më vonë se më 28 shkurt 2021.



Huadhënësi i jep Huamarrësit një grafik shlyerjeje menjëherë sapo të jenë përcaktuar datat faktike të shlyerjes në pajtim me termat e tij.

Nëse një datë shlyerjeje nuk është ditë pune, pagesa bëhet në ditën paraprirëse të punës.

Çdo kësht shlyerjeje kreditohet në llogarinë e instrumentit.

#### 4.2 Parapagesa opsionale dhe anulimi

Huamarrësi, me njoftim me shkrim drejtuar Huadhënësit dhe në pajtim me pëlqimin paraprak të Huadhënësit dhe OeKB-së, ku këtë pëlqim Huadhënësi e ushtron me kërkesë të Huamarrësit, mund të parapaguajë huan në pajtim me termat dhe kushtet e specifikuar nga Huadhënësi dhe OeKB-ja.

Çdo parapagim zbatohet mbi kështet pasuese të kërkueshme të shlyerjes, që duhet të paguhen sipas kësaj marrëveshjeje.

Huamarrësi zhdëmton Huadhënësin për të gjitha shpenzimet për humbjet (duke përfshirë, pa u kufizuar, shpenzimet në lidhje me marrëveshjen e rifinancimit të OeKB-së dhe garancinë e OeKB-së) të bëra nga Huadhënësi, që kanë të bëjnë me çdo pagesë të tillë të parapagimit. Huadhënësi informon Huamarrësin për këto shpenzime për humbjet në momentin që Huamarrësi kërkon parapagimin. Nëse Huamarrësi është informuar në lidhje me këto shpenzime për humbjet, Huamarrësi mund të vendosë të bëjë parapagimin dhe të paguajë shpenzimet për humbjet ose të mos bëjë parapagimin.

Për mënjanimin e dyshimit, pavarësisht zvogëlimit të shumës principale si rezultat i kësteve të shlyerjes të shkaktuara nga ky parapagim, detyrimet e garancisë së OeKB-së mund të kërkojnë nga OeKB-ja mbi bazën e grafikut fillestar të pagesës. Një rregullim i këtyre detyrimeve të garancisë së OeKB-së i nënshtrohet aprovimit të OeKB-së për të ulur përkatësisht detyrimet për garancinë e OeKB-së.

Shumat e shlyera ose të parapaguara nuk mund të ritërhiqen.

Shuma e instrumentit të kredisë e patërhequr në fund të periudhës së disponibilitetit anulohet automatikisht me mbylljen e aktivitetit në Vjenë në ditën e fundit të kësaj periudhe disponibiliteti, përveç kur Huadhënësi dhe Huamarrësi kanë rënë dakord për të shtyrë periudhën e disponibilitetit.

### 5. PAGESAT

#### 5.1 Njoftimi i pagesës

Jo më vonë se katërmbëdhjetë ditë para çdo date të kërkueshme të tarifës së përkushtimit dhe garancisë së OeKB-së ose, sipas rastit, datës së shlyerjes, Huadhënësi njofton Huamarrësin për këto shuma që janë të kërkueshme për t'iu paguar nga Huamarrësi. Huadhënësit në pajtim me dispozitat e kësaj marrëveshjeje, me kusht që mosbërja e njoftimit si më sipër nuk e liron Huamarrësin nga detyrimi i tij për të bërë pagesat e këtyre shumave të mësipërme kur bëhen të kërkueshme.

#### 5.2 Metoda e pagesës

Në çdo datë pagese, Huamarrësi e bën pagesën e shumave të kërkueshme në këtë datë në Vjenë, në vlerën sipas datës përkatëse të kërkueshme.

Përveç kur është e rregulluar ndryshe, nëse një datë pagese nuk është ditë pune, pagesa bëhet në ditën paraprirëse të punës.

Të gjitha pagesat e shumave që i kërkojnë Huamarrësit nga Huadhënësi bëhen në euro lirisht të konvertueshme dhe të transferueshme.

#### 5.3 Pagesa të lira nga mbajtja e taksave dhe e detyrimeve të tjera

Të gjitha pagesat e bëra nga Huamarrësi sipas kësaj marrëveshjeje, llogariten dhe bëhen plotësisht pa kompensim ose kundërpretendim (dhe të lira nga çdo zbritje e tillë).

Huamarrësi heq dorë nga të gjitha të drejtat e kompensimit ose kundërpretendimit që mund të ketë në lidhje me një shumë të kërkueshme nga Huadhënësi dhe bie dakord që nuk do të mbajë pagesa për asnjë arsye të shumave të kërkueshme për pagesë. Veçanërisht, Huamarrësi nuk mban pagesën e shumave të kërkueshme nga Huadhënësi për shkak se ai ka pretendime, të drejtë padie, të

drejta ose kërkesa kundrejt eksportuesit të projektit ose furnitorëve të tjerë në lidhje me projektin ose kontratën për dhënien e projektit.

Nëse Huamarrësi bën një pagesë sipas kësaj marrëveshjeje në lidhje me të cilën i kërkohet të zbresë ose të mbajë taksa ose shuma të tjera, shumat bruto që paguhen nga Huamarrësi zmadhohen me ato shuma që, pas zbritjes ose mbajtjeve, të jenë të barabarta me shuma faktike që do të merreshin nëse nuk do të kërkoheshin këto zbritje ose shuma dhe Huamarrësi zhdëmton Huadhënësin kundrejt çdo humbjeje ose shpenzimi të shkaktuar për shkak të moskryerjes nga Huamarrësi të këtyre zbritjeve ose mbajtjeve.

Huamarrësi (brenda tri ditëve pune me kërkesë të Huadhënësit) i paguan Huadhënësit një shumë të barabartë me humbjen, detyrimin ose shpenzimin, që Huadhënësi përcakton se do të pësojë ose është pësuar (drejtpërdrejt ose jo) ose për llogaritë e tatimit jashtë Austrisë nga Huadhënësi në lidhje me këtë marrëveshje. Ky paragraf nuk zbatohet në lidhje me ndonjë tatim të vlerësuar për Huadhënësin sipas ligjit austriak, si ligji i themelimit të Huadhënësit ose, nëse është i ndryshëm, ligji i juridiksionit (ose juridiksioneve) në të cilin Huadhënësi trajtohet si rezident për qëllimet tatimore, nëse ky tatim vendoset ose llogaritet duke iu referuar të ardhurave neto të marra ose që janë të mundshme për t'u marrë nga Huadhënësi. Huadhënësi i jep Huamarrësit prova të arsyeshme për këtë humbje, detyrim ose shpenzime.

#### 5.4 Përvetësimi i pagesave

Të gjitha pagesat e marra nga Huadhënësi prej Huamarrësit (përveç kur Huadhënësi ndryshon rendin e zbatimit) zbatohen nga Huadhënësi kundrejt pagesës së shumave të kërkueshme në rendin e mëposhtëm, dhe Huamarrësi bie dakord për zbatimin e këtyre pagesave në këtë rend (dhe për çdo ndryshim të kryer nga Huadhënësi):

- i) shumat e kërkueshme sipas nenit 3.4 (shpenzimet);
- ii) shumat e kërkueshme sipas nenit 3.2 (tarifa e menaxhimit);
- iii) shumat e kërkueshme sipas nenit 3.3 (pagesat dhe shpenzimet e garancisë së OeKB-së);
- iv) shumat e kërkueshme sipas nenit 3.1 (tarifa e përkushtimit);
- v) shumat e kërkueshme sipas nenit 2.2 (interesi i munguar);
- vi) shumat e kërkueshme sipas nenit 3.5 (shpenzimet e shtuara);
- vii) shumat e kërkueshme sipas nenit 4.1 (shlyerja);
- viii) shumat e kërkueshme sipas nenit 4.1 (shlyerja);
- ix) shumat e kërkueshme sipas nenit 4.2 (parapagesa opsionale).

#### 6. PARAKUSHTE

Kjo marrëveshje nuk bëhet pa kushte dhe instrumenti i kredisë nuk bëhet i disponueshëm për Huamarrësin për çdo rast deri në atë datë (data e hyrjes në fuqi) në të cilën Huadhënësi ka njoftuar Huamarrësin që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

i) Huadhënësit i janë dhënë të gjitha dokumentet e mëposhtme në gjuhën angleze ose të shoqëruar me një përkthim të certifikuar në anglisht dhe në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Huadhënësin:

a) provë shkresore (prokurë) për autoritetin e personit(ave) që nënshkruajnë këtë marrëveshje dhe ekzemplarët e firmave për këta persona, të vërtetuara nga një nëpunës i Ministrisë së Financave të Shqipërisë;

b) një kopje të ligjit që ratifikon këtë marrëveshje;

c) autorizim me shkrim nga Ministria e Financave për personat e autorizuar për të nënshkruar udhëzimet e pagesës për livrimet sipas instrumentit të kredisë dhe ekzemplarët e nënshkrimeve të këtyre personave të vërtetuar nga Ministri i Financave të Shqipërisë;

d) një kopje të kontratës së dhënies së projektit së bashku me një konfirmim të Qualys-it në formën e parashikuar në aneksin 3, që konfirmon që të gjitha kushtet (të ndryshme nga kushtet në lidhje me efektivitetin e marrëveshjes) për efektivitetin e kontratës së dhënies së projektit janë përmbushur dhe kontrata e dhënies së projektit në formën e paraqitur Huadhënësit është në fuqi të



plotë;

e) një mendim ligjor nga Ministria e Drejtësisë e Shqipërisë nga përmbajtja në formën e aneksit 2;

f) caktimi i Ambasadorit të Shqipërisë në Austri si agjent procesi nga Huamarrësi në formën e aneksit 4;

g) ekzemplarët e nënshkrimeve të personit ose personave të autorizuar për të nënshkruar protokollet e pranimit në pajtim me aneksin 1 “Procedura e pagesës” në emër të Blerësit të projektit.

ii) Huadhënësi duhet të ketë marrë:

a) garancinë e OeKB-së në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Huadhënësin;

b) marrëveshjen e rifinancimit të OeKB-së në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Huadhënësin;

c) çdo autorizim tjetër që mund të kërkohet.

iii) Huadhënësi duhet të ketë përfunduar një letër mbështetëse me eksportuesit e projektit në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Huadhënësin.

Me përmbushjen e të gjitha kushteve të mësipërme, Huadhënësi njofton menjëherë Huamarrësin për këtë qëllim. Nëse këto kushte nuk janë përmbushur deri më 30.5.2013 (data përfundimtare e hyrjes në fuqi), kjo marrëveshje, përveç detyrimeve të Huamarrësit sipas nenit 3, pushon së qeni detyruese për palët.

## 7. NGJARJE TË QENIES NË VONESË

### 7.1 Ngjarje të qenies në vonesë

Secila prej ngjarjeve ose rrethanave të mëposhtme është një ngjarje e qenies në vonesë (pavarësisht nëse ndodhia e kësaj ngjarjeje ose rrethane është tej kontrollit të Huamarrësit). Huamarrësi dhe Huadhënësi bien dakord që çdo ngjarje e qenies në vonesë është e justifikuar objektivisht brenda kuptimit të legjislacionit përkatës austriak:

a) Huamarrësi nuk paguan një shumë të kërkueshme sipas kësaj marrëveshjeje në datën kur bëhet e kërkueshme ose në vendin dhe në monedhën në të cilën është parashikuar të jetë e pagueshme;

b) Huamarrësi nuk respekton një detyrim tjetër nga ana e tij sipas kësaj marrëveshjeje, që nuk është e mundur të rikuperohet ose, nëse është e rikuperueshme, nuk është rikuperuar brenda dhjetë (10) ditëve, duke filluar nga e para: i) e momentit kur huadhënësi i bën njoftim Huamarrësit; dhe ii) nga momenti kur Huamarrësi vjen në dijeni të mospërmbushjes;

c) Huamarrësi nuk paguan një borxh sipas një marrëveshjeje sipas së cilës ai është i detyruar të paguajë parë ose një interes apo premium për të, kur bëhet e kërkueshme dhe kjo mospërmbushje vazhdon pas periudhës së zbatueshme të faljes, sipas rastit, të specifikuar në marrëveshjen në lidhje me borxhin; ose një qenie tjetër të vonesës sipas një marrëveshjeje në lidhje me këtë borxh ose një ngjarjeje tjetër dhe kjo vazhdon pas periudhës së faljes, sipas rastit të specifikuar në këtë marrëveshjeje, nëse efekti i kësaj qenieje në vonesë ose ngjarjeje është përshpejtimi ose lejimi i përshpejtimit të maturitetit të këtij borxhi; ose një borxh i tillë deklarohet i kërkueshëm dhe i pagueshëm apo bëhet i përshtatshëm për t’u deklaruar i kërkueshëm dhe i pagueshëm, ose kërkohet të parapaguhet (që nuk është një parapagesë e kërkuar rregullisht sipas grafikut), para maturimit të deklaruar ose ndërmerren hapat për të ekzekutuar një garanci për këtë; ose nëse një detyrim për një borxh financiar të Huamarrësit anulohet ose pezullohet nga një kreditor i Huamarrësit;

d) një përfaqësim, garanci ose deklarim i bërë ose mendohet të jetë bërë në lidhje me këtë marrëveshje ose në një dokument të dhënë nga ose për llogari të Huamarrësit sipas ose në lidhje me këtë marrëveshje ose vërtetohet të jetë jo e vërtetë, jokorrekte ose e gabuar në një aspekt material kur është bërë ose menduar të jetë bërë ose nuk mund të rinovohet në pajtim me dispozitat e saj në një aspekt që është i rëndësishëm;

e) një licencë, pëlqim, regjistrim ose aprovim (qeveritar ose tjetër) i kërkuar nga Huamarrësi ose që kërkohet për vlefshmërinë, ekzekutueshmërinë ose ligjshmërinë e kësaj

marrëveshjeje, huas, garancisë së OeKB-së, marrëveshjes së rifinancimit të OeKB-së, kontratës së dhënies së projektit, projektit ose përmbushjes së tij është tërhequr ose ndryshuar në një mënyrë të dëmshme për Huadhënësin ose pushon së qeni në fuqi për një arsye të caktuar; ose Huamarrësi nuk përmbush një licencë, pëlqim, regjistrim ose aprovim të tillë;

f) Huamarrësi nuk është në gjendje ose pranon paaftësinë të paguajë borxhet nëse janë të kërkueshëm, pezullon bërjen e pagesave për një prej borxheve të tij ose, për shkak të vështirësive faktike ose të pritshme financiare, fillon negociimet me një ose më shumë kreditorë, me qëllim që të riskedulohet ndonjë prej borxheve të tij; ose një moratorium ose një përbërje, ose një masë me kreditorët ose një procedurë e ngjashme ose masë, zbatohet ose diskutohet;

g) pas datës së nënshkrimit ka një ndryshim në gjendjen financiare të Huamarrësit dhe një ndryshim i tillë mund të jetë, sipas mendimit të arsyeshëm të Huadhënësit, të ketë një efekt material negativ;

h) në një moment të caktuar është ose bëhet e paligjshme për Huamarrësin të përmbushë ose të respektojë një ose të gjitha detyrimet sipas kësaj marrëveshjeje ose një prej detyrimeve të Huamarrësit sipas kësaj marrëveshjeje nuk janë ose pushojnë së qeni të ligjshme, të vlefshme ose detyruese;

i) Huamarrësi e denoncon këtë marrëveshje ose kryen ose merr masa për kryerjen e një veprimi ose akti që provon një synim për denoncimin e kësaj marrëveshjeje;

j) kontrata e dhënies së projektit bëhet ose është për një shkak të caktuar plotësisht ose pjesërisht e pavlefshme ose pushon së qeni në fuqi;

k) një nga lejet që kërkohet për projektin ose një çështje në lidhje me të pushon së qeni në fuqi;

l) h) garancia e OeKB-së ose një prej dispozitave të saj revokohet, shfuqizohet ose pushon së qeni në fuqi ose pushon të japë garancinë e synuar ose bëhet e paligjshme për një arsye, ngjarje ose rrethanë të caktuar që mund t'i vishet sferës së Huamarrësit;

m) Shqipëria deklaron një moratorium të përgjithshëm për detyrimet e saj për pagesë kundrejt kreditorëve ose fillon bisedimet për riskedulimin e detyrimeve të pagesës; ose Shqipëria pushon së qeni anëtar i Fondit Monetar Ndërkombëtar ose pushon së pasuri të drejtën për të përdorur burimet e përgjithshme dhe specifike ose instrumentet e tyre;

n) ndodh një ngjarje ose rrethanë tjetër, që Huadhënësi përcakton se ka një efekt material negativ.

## 7.2 Veprimi në rastin e ngjarjes së qenies në vonesë

Në çdo moment pas ndodhies së ngjarjes së qenies në vonesë, Huadhënësi, duke njoftuar Huamarrësin: a) anulon instrumentin e kredisë dhe instrumenti i kredisë anulohet menjëherë; dhe/ose b) deklaron që e gjithë ose një pjesë e huas, së bashku me të gjitha shumat e tjera të mbledhura ose të papaguara sipas kësaj marrëveshjeje të jenë menjëherë të pagueshme dhe të kërkueshme, dhe pas kësaj ato bëhen menjëherë të kërkueshme dhe të pagueshme; dhe/ose c) deklaron që e gjithë ose një pjesë e huas së bashku me të gjitha shumat e tjera të mbledhura ose të papaguara sipas kësaj marrëveshjeje të jenë të pagueshme me kërkesë, dhe pas kësaj ato bëhen menjëherë të pagueshme me kërkesë nga Huadhënësi. Huadhënësi ka të drejtë më tej të marrë çdo veprim tjetër që huadhënësi vendos të ndërmarrë në diskrecionin e tij absolut.

## 8. GARANCI DHE DETYRIME

### 8.1 Garanci

Me qëllim që Huadhënësi të shtyhet të lidhë këtë marrëveshje dhe të japë dhe të vazhdojë huan, Huamarrësi jep garancitë e mëposhtme:

a) është një shtet sovran i përfaqësuar rregullisht nga ministria e tij e financave me ekzistencë të përhershme, në gjendje për të paditur dhe për t'u paditur, dhe që ka tagrin dhe autoritetin për të lidhur këtë marrëveshje dhe të ushtrojë të drejtat dhe përmbushur detyrimet e tij; janë ndërmarrë të gjitha veprimet e kërkuara për të autorizuar nënshkrimin nga Huamarrësi të kësaj



marrëveshjeje dhe përmbushjen e detyrimeve të tij sipas saj. Ai ka tagrin të ketë në pronësi sendet e tij pasurore, të cilat janë në disponimin e pakufizuar të Huamarrësit;

b) nënshkrimi, dhënia dhe përmbushja e kësaj marrëveshjeje nuk shkel dhe nuk do të shkelë asnjë dispozitë të ndonjë ligji ose rregulloreje ekzistuese të zbatueshme për Huamarrësin (duke përfshirë ligjet dhe rregulloret në lidhje me subvencionet);

c) nënshkrimi dhe përmbushja e kësaj marrëveshjeje janë autorizuar rregullisht dhe në mënyrë të vlefshme nga Huamarrësi dhe të gjitha licencat, pëlqimet, regjistrimi tregtar dhe aprovimet (qeveritare ose tjetër) të nevojshme ose të dëshirueshme në lidhje me nënshkrimin, dhënien ose përmbushjen e kësaj marrëveshjeje janë marrë dhe janë në fuqi të plotë. Kjo marrëveshje përbën detyrime të ligjshme, të vlefshme dhe detyruese për Huamarrësin të ekzekutueshme në pajtim me termat e tyre;

d) Huamarrësi nuk ka krijuar ose rënë dakord të krijojë ndonjë hipotekë, peng, barrë ose mjet tjetër për sigurimin e padisë plotësisht ose pjesërisht në sendet e tij pasurore për të siguruar një detyrim të jashtëm ose detyrim të brendshëm afatgjatë.

“Detyrime të jashtme”, siç përdoret këtu, janë detyrimet për fonde të marra hua nga një bankë, institucion financiar ose subjekt tjetër të themeluar, që gjendet ose është rezidente jashtë Shqipërisë dhe “detyrim i brendshëm afatgjatë”, siç përdoret këtu është një detyrim i Huamarrësit për fonde të marra hua nga Huadhënës që është themeluar, ndodhet apo është rezidente si më sipër në Shqipëri dhe që ka një maturim përfundimtar prej më shumë se pesë vjet.

e) Huadhënësit i është bërë deklaram i plotë për të gjitha faktet në lidhje me Huamarrësin që janë të konsiderueshme dhe duhet të bëhen normalisht të njohura çdo personi ose personave që propozojnë të japin ose vënë në dispozicion fonde për Huamarrësin;

f) nuk ka ndodhur asnjë ngjarje e qenies në vonesë dhe nuk mund të rezultojë nga dhënia e huas; nuk ka ndodhur asnjë ngjarje tjetër që të përbëjë (ose me bërjen e njoftimit, parashkrimin, përcaktimin e rëndësisë ose përmbushjen e një kushti tjetër të zbatueshëm ose një kombinim të sa më sipër, mund të përbëjë) një qenie në vonesë sipas një marrëveshjeje ose instrumenti që është detyrues për Huamarrësin ose një prej sendeve të tij pasurore në një masë ose në një mënyrë që mund të ketë një efekt material negativ;

g) nuk po zhvillohet dhe nuk është në pritje asnjë gjykim, arbitrazh apo procedurë administrative ose, sipas dijenisë së tij, kjo nuk e kërcënon Huamarrësin, që, nëse vendoset në mënyrë negative, mund të ketë një efekt material negativ ose që mund të vinte në pikëpyetje ekzekutueshmërinë ose pranueshmërinë provuese të kësaj marrëveshjeje;

h) detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj marrëveshjeje janë detyrime të drejtpërdrejta, të përgjithshme dhe pa kushte të Huamarrësit dhe renditen dhe do të renditen të paktën *pari passu* me të gjitha detyrimet e tashme dhe të ardhme të pasiguruarra dhe të pavarura (duke përfshirë detyrimet rastësore) të Huamarrësit me përjashtim të atyre detyrimeve që janë detyrimisht të preferuara me ligj;

i) çdo informacion faktik i dhënë nga Huamarrësi Huadhënësit në lidhje me negociimin dhe përgatitjen e kësaj marrëveshjeje ose transaksionet e provuara në të ka qenë i vërtetë dhe i saktë në të gjitha aspektet dhe jo i gabuar në datën që është dhënë ose në datën (sipas rastit) që është shprehur. Nuk është dhënë apo mbajtur asnjë informacion që e bën informacionin e dhënë më parë të pavërtetë ose të gabuar në një aspekt material. Për më tepër, çdo informacion i tillë nuk ka lënë mënjanë fakte dhe asgjë nuk ka ndodhur që nga momenti që informacioni i është dhënë Huadhënësit, i cili, nëse deklarohet, mund të ndikojë negativisht vendimin e një personi që futet në këtë marrëveshje;

j) nuk është e nevojshme që kjo marrëveshje të depozitohet, regjistrohet ose listohet në një gjykatë ose autoritet tjetër në Shqipëri ose të paguhet një tatim pulle, regjistrimi apo i ngjashëm për ose në lidhje me këtë marrëveshje ose transaksionet e parashikuara në të;

k) zgjedhja e ligjit austriak si ligj rregullues i kësaj marrëveshjeje njihet dhe ekzekutohet në Shqipëri; çdo vendim arbitrazhi/vendim i dhënë në lidhje me këtë marrëveshje njihet dhe ekzekutohet në Shqipëri;

l) për lidhjen e kësaj marrëveshjeje, Huamarrësi vepron në emër të tij dhe jo si agjent apo ndërmjetës në emër të një pale të tretë.

Përfaqësimet dhe garancitë e parashikuara në këtë nen 8.1 bëhen në datën e nënshkrimit dhe konsiderohen të përsëriten nga Huamarrësi në çdo datë që kërkohet një huamarrje ose bëhet në çdo datë pagese dhe datë shlyerjeje, duke iu referuar fakteve dhe rrethanave që ekzistojnë.

## 8.2 Detyrimet

Huamarrësi merr përsipër nga kjo datë dhe për aq kohë sa të mos jetë shlyer një pagesë të pagueshme ose nëse mund të vazhdojnë të bëhen tërheqjet si më poshtë:

a) i bën njoftim të menjëhershëm me shkrim Huadhënësit dhe i jep Huadhënësit hollësitë për këtë:

i) çdo gjykim, arbitrazh ose procedurë administrative që po kryhet faktikisht, është në pritje ose i kërcënohet Huamarrësit, e cila nëse vendoset negativisht, mund të ketë një efekt material negativ;

ii) një çështje (tjetër), që mund të pritët në mënyrë të arsyeshme për të ndikuar në mënyrë materiale dhe negative aftësinë e Huamarrësit për të përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj marrëveshjeje ose që mund të ketë ndryshe një efekt material negativ;

iii) tërheqjen ose ndryshimin e autorizimeve, aprovimeve ose regjistrimeve që kërkohen në lidhje me këtë marrëveshje, kontratën e dhënies së projektit ose projektin;

iv) ndodhinë e një ngjarjeje të qenies në vonesë ose një ngjarjeje, e cila, me bërjen e njoftimit, parashkrimin, përcaktimin e vërtetësisë ose përmbushjen e një kushti tjetër të zbatueshëm ose një kombinim sa më sipër, mund të përbëjë një ngjarje të qenies në vonesë me një përshtatje të hapave që po ndërmerr ose ka ndërmend të ndërmarrë, me qëllim që të korrigjojë ose të zbusë efektin pas marrjes dijeni për një ngjarje të tillë;

v) çdo informacion tjetër që mund të kërkohet nga ligjet ose rregulloret e zbatueshme mbikëqyrëse bankare dhe/ose në pajtim me praktikën standarde bankare.

b) ai respekton të gjitha ligjet e zbatueshme dhe të gjitha autorizimet, aprovimet dhe regjistrimet në lidhje me këtë marrëveshje, garancinë e OeKB-së, marrëveshjen e rifinancimit të OeKB-së, kontratën e dhënies së projektit dhe projektin dhe merr dhe rinovon menjëherë herë pas here këto autorizime dhe aprovime dhe realizon ato regjistrime të tjera, që mund të jenë eventualisht të nevojshme për të mundësuar përmbushjen e detyrimeve sipas kësaj marrëveshjeje, në lidhje me kontratën e dhënies së projektit, projektin, garancinë e OeKB-së dhe marrëveshjen e rifinancimit të OeKB-së. Huamarrësi, me kërkesë të Huadhënësit, i jep kopje të certifikuara Huadhënësit për çdo autorizim, aprovim ose regjistrim në lidhje me këtë marrëveshje;

c) ai merr masa që detyrimet e tij sipas kësaj marrëveshjeje të renditen të paktën *pari passu* me të gjitha detyrimet e tij të tjera të tashme dhe të ardhme, të siguruara dhe të pavarura, përveç kur preferohen në mënyrë të detyrueshme me ligj. Huamarrësi nuk krijon ose bie dakord të krijojë ndonjë hipotekë, barrë, peng, të drejtë pengu ose mjet tjetër të sigurimit të padisë për të gjithë ose një pjesë të sendeve të tij pasurore për të siguruar një detyrim të jashtëm ose detyrimet e brendshme afatgjata ose të sigurojë një garanci për një detyrim të jashtëm ose detyrimet e brendshme afatgjata, përveç kur huaja sigurohet në mënyrë të barabartë në mënyrë të pranueshme për Huadhënësin;

d) ai mban ose merr masa për mbajtjen e regjistrave të përshtatshëm për të identifikuar mallrat dhe/ose shërbimet e financuara nga kjo marrëveshje, për të deklaruar përdorimin në projekt, për të regjistruar progresin e projektit, duke përfshirë koston e tij dhe për të reflektuar në pajtim me praktikën e llogarive të mbajtura në mënyrë uniforme dhe të pranueshme ndërkombëtarisht operacionet dhe gjendjen financiare të Huamarrësit;



e) ai lejon (ose realizon lejimin) përfaqësuesit e huadhënësit të inspektojnë projektin, Blerësin e projektit dhe eksportuesit e projektit, mallrat dhe shërbimet e dhëna në pajtim me kontratën e dhënies së projektit dhe çdo regjistër ose dokument përkatës dhe jep apo merr masa për dhënien Huadhënësit të atij informacioni që Huadhënësi kërkon në mënyrë të arsyeshme në lidhje me shpenzimet e huas, projektit dhe mallrat dhe/ose shërbimet e dhëna në pajtim me kontratën për dhënien e projektit;

f) ai nuk bën, lejon apo bie dakord për një ndryshim material, amendim apo modifikim apo prishje të kontratës së dhënies së projektit pa pëlqimin paraprak me shkrim të Huadhënësit.

#### 9. LIGJI I ZBATUESHËM, JURIDIKSIONI DHE HEQJA DORË NGA IMUNITETI

Kjo marrëveshje rregullohet nga ligji austriak, duke përjashtuar dispozitat e së drejtës ndërkombëtare private dhe duke përjashtuar zbatimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara për kontratat për shitjen ndërkombëtare të mallrave, 1980.

Të gjitha mosmarrëveshjet që rrjedhin nga ose në lidhje me këtë marrëveshje zgjidhen përfundimisht sipas rregullave të arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë me tre arbitra të caktuar në pajtim me rregullat përkatëse. Vendi i arbitrazhit është Parisi. Gjuha që përdoret në gjykimin në arbitrazh është anglishtja.

Nëpërmjet nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, si Huamarrësi ashtu edhe Huadhënësi konfirmojnë shprehimisht lidhjen e kësaj kontrate dhe marrja përsipër e detyrimeve që rrjedhin prej saj nga ana e Huamarrësit dhe Huadhënësit përfaqësojnë vetëm aktivitetet e tyre tregtare.

Huamarrësi heq dorë në mënyrë të parevokueshme nga çdo imunitet që ai ose prona e tij mund të ketë të drejtën për momentin, qoftë ky i karakterizuar si imunitet sovran apo tjetër, nga çdo kompensim ose padi në Austri, Shqipëri apo gjetkë, duke përfshirë imunitetin nga pranimi i padisë, imunitetin nga juridiksioni i një gjykate ose arbitrazhi, imunitetin e pronës së tij ndaj sekuestrimit para vendimit ose ndaj ekzekutimit të një vendimi. Si përjashtim, Huamarrësi nuk heq dorë nga asnjë imunitet në lidhje me ekzekutimin e një vendimi arbitrazhi, në lidhje me:

i) “ambientet e misionit” të tashme ose të ardhme sipas përkufizimit të Konventës së Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike të nënshkruar më 1961, “ambientet konsullore” të tashme ose të ardhme të përkufizuara në Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore të nënshkruar më 1963 ose ndryshe të përdorura nga një diplomat ose mision diplomatik i Shqipërisë;

ii) një pasuri e patundshme që futet në sferën e nenit 3, paragrafët 1-3 të ligjit shqiptar nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, i ndryshuar; dhe

iii) çdo fond monetar dhe/ose shumë që është bërë tashmë e kërkuar dhe e paguar në momentin e ekzekutimit për përmbushjen e detyrimeve të Republikës së Shqipërisë sipas së drejtës publike, traktateve, konventave dhe/ose marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkruara prej saj.

#### 10. TË NDRYSHME

##### 10.1 Garancia e OeKB-së

Huamarrësi njeh që instrumenti i kredisë do të garantohet nëpërmjet një garancie të OeKB-së sipas ligjit austriak të nxitjes së eksportit, i ndryshuar.

Për më tepër, Huamarrësi njeh që Huadhënësi, në pajtim me termat dhe kushtet që rregullojnë garancinë e OeKB-së, është i detyruar të ndjekë udhëzimet e dhëna nga OeKB-ja dhe bie dakord shprehimisht që ai do të respektojë çdo veprim ose mosveprim të Huadhënësit sipas këtyre udhëzimeve.

##### 10.2 Njoftimet

Përveç kur është parashikuar ndryshe në këtë marrëveshje, çdo njoftim që jepet ose çdo dokument që paraqitet dërgohet me faks, shërbim korrieri ose postë të regjistruar apo e-mail ose kopje të skanuara të letrave të nënshkruara. Në rastin e komunikimeve me faks ose e-mail nga Huamarrësi drejtuar Huadhënësit, Huamarrësi është përgjegjës kundrejt Huadhënësit për të gjitha dëmet që rrjedhin nga ky lloj transmetimi, veçanërisht nëse ato janë për shkak të mungesës së autoritetit, falsifikimit ose gabimeve në transmetim.

Çdo njoftim që paraqitet sipas kësaj marrëveshjeje është në anglisht. Çdo dokument që paraqitet sipas kësaj marrëveshjeje është në anglisht dhe, përveç kur bihet dakord ndryshe nga Huadhënësi, nëse nuk është në anglisht, shoqërohet me një përkthim të certifikuar në anglisht dhe, në këtë rast, përkthimi ka prioritet përveç kur dokumenti është një dokument statutor ose tjetër zyrtar. Nëse kjo marrëveshje parashikon që Huamarrësi është i detyruar t'i paraqesë Huadhënësit një dokument pa specifikuar nëse duhet të jetë origjinali i këtij dokumenti apo jo, Huamarrësi është i detyruar të paraqesë origjinalin e këtij dokumenti ose një kopje të certifikuar, përveç kur Huadhënësi informon Huamarrësin që ai pranon një kopje të pacertifikuar të këtij dokumenti. Çdo njoftim ose dokument dërgohet:

Për Huadhënësin:

Erste Bank der Oesterreichischen Sparkassen AG

Brandstätte 7 - 9, 1010 Vienna, Austria

Në vëmendje të: Ms. Brigitte Schubert or Mr. Thomas Oberndorfer

tel. +43 5 0100 – 18536 or +43 5 0100 - 13826

fax: +43 5 0100 9 – 18536 or +43 5 0100 9 - 13826

e-mail: [brigitte.schubert@erstegroup.com](mailto:brigitte.schubert@erstegroup.com) [thomas.oberndorfer@erstegroup.com](mailto:thomas.oberndorfer@erstegroup.com)

Për Huamarrësin:

Republika e Shqipërisë përfaqësuar nga Ministria e Financave

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr. 4, Tirana, Albania

Në vëmendje të: Ministri i Financave

tel. +355 4222 84 05

fax: +355 222 84 94

e-mail: [sekretariamin@minfin.gov.al](mailto:sekretariamin@minfin.gov.al)

ose në atë adresë, adresë e-mail-i, numër personi ose faksi që njoftohet nga njëra palë palës tjetër. Çdo komunikim ose dokument që bëhet ose i paraqitet Huadhënësit do të jetë në fuqi vetëm pasi të jetë marrë faktikisht nga Huadhënësi.

#### 10.3 Ndryshimet dhe titujt përshkrues

Çdo ndryshim ose modifikim i kësaj marrëveshjeje është vetëm me shkrim dhe duhet të nënshkruhet rregullisht nga të dyja palët. Ministri i Financave është i autorizuar të nënshkruajë çdo ndryshim që duhet të aprovohet nga Këshilli i Ministrave. Ndryshimet në këtë marrëveshje që prekin vetëm periudhën e disponibilitetit nuk kërkojnë aprovimin paraprak të Këshillit të Ministrave.

Titujt në këtë marrëveshje janë vetëm për lehtësi reference dhe nuk përkufizojnë apo kufizojnë dispozitat e saj.

#### 10.4 Heqja dorë, mjetet mbrojtëse kumulative

Një mosushtim apo një vonesë në këtë ushtrim nga ana e Huadhënësit të një të drejte ose mjeti mbrojtës sipas kësaj marrëveshjeje nuk konsiderohet si heqje dorë dhe një ushtrim i vetëm ose i pjesshëm i një të drejte ose mjeti mbrojtës nuk mënjanon një ushtrim tjetër ose të mëtejshëm apo ushtrimin e një të drejte apo mjeti tjetër. Të drejtat dhe mjetet mbrojtëse të parashikuara në këtë marrëveshjeje janë kumulative dhe nuk janë përjashtuese për të drejtat dhe mjetet e parashikuara me ligj.

#### 10.5 Zhdëmtimet

Me kërkesë Huamarrësi zhdëmton menjëherë Huadhënësin kundrejt çdo shpenzimi, humbjeje (duke përfshirë humbjet e marzhit) ose detyrimi të shkaktuar prej tij si pasojë:

i) e moskryerjes nga huamarrësi i një pagese të një shume të kërkueshme sipas kësaj marrëveshjeje në datën e kërkueshme;

ii) e ndodhisë së ngjarjes së qenies në vonesë;

iii) e financimit ose marrjes së masave për financimin, një tërheqjeje të kërkuar nga Huamarrësi por që nuk është bërë për shkak të zbatimit të një ose disa dispozitave të kësaj marrëveshjeje (vetëm të ndryshme nga qenia në vonesë ose neglizhenca nga ana e Huadhënësit); ose



iv) e huas (ose pjesë të huas) që nuk është parapaguar në pajtim me një njoftim për parapagim.

Detyrimi i Huamarrësit në çdo rast përfshin çdo humbje ose shpenzim për llogari të fondeve të tërhequra, kontraktuara ose përdorur për të financuar një shumë të pagueshme sipas kësaj marrëveshjeje, një shumë të ripaguar ose parapaguar, një tërheqje ose hua.

Nëse, për shkak të pagesave të bëra nga Huamarrësi në pajtim me nenin 4.2 (parapagimi opsional dhe anulimi), ose për shkak të përshpejtimit të maturimit të huas ose për shkak të një arsyeje tjetër, çdo pagesë sipas kësaj marrëveshjeje që merret në një datë të ndryshme nga data e pagesës së planifikuar, Huamarrësi i paguan Huadhënësit me kërkesë çdo shumë që kërkohet për të kompensuar Huadhënësin për çdo humbje, shpenzime ose kosto shtesë që mund të pësojë si rezultat i kësaj pagese. Detyrimi i Huamarrësit në këto raste përfshin çdo humbje ose shpenzim për llogari të fondeve të tërhequra, kontraktuara ose përdorur për të financuar një shumë të pagueshme sipas kësaj marrëveshjeje, një shumë të ripaguar ose parapaguar, si dhe çdo humbje marzhi.

Asnjë pagesë për Huadhënësin sipas kësaj marrëveshjeje në pajtim me një vendim ose urdhër gjykate ose tjetër nuk zbatohet për të liruar Huamarrësin nga detyrimet në lidhje me të cilat është dhënë, përveç kur dhe derisa pagesa të jetë marrë plotësisht në monedhën në të cilën shuma është e pagueshme (monedha e detyrimit) dhe, në masën që shuma e një pagese të tillë në konvertimin në monedhën e detyrimit, e shprehur në monedhën e detyrimit, është më e vogël se shuma që kërkohej fillimisht nga Huadhënësi në monedhën e detyrimit, Huadhënësi ka një shkak tjetër dhe të veçantë padie kundrejt huamarrësit për rikuperimin e asaj shume që pas konvertimit në monedhën e detyrimit të jetë e barabartë me shumën e diferencës. Huamarrësi heq dorë nga çdo e drejtë që mund të ketë në një juridiksion për të paguar një shumë sipas kësaj marrëveshjeje në një monedhë ose njësi monedhe të ndryshme nga ajo që është parashikuar të jetë e pagueshme.

#### 10.6 Pavlefshmëria e pjesshme

Palët bien dakord që nëse në një moment të caktuar një dispozitë e kësaj marrëveshjeje është ose bëhet e pavlefshme apo mbetet pa fuqi për një shkak të caktuar, kjo nuk cenon vlefshmërinë ose efektivitetin e dispozitave të tjera dhe kjo marrëveshje mbetet e vlefshme dhe efektive, përveç dispozitave të pavlefshme dhe të paefektshme, ku asnjë nga palët nuk duhet të argumentojë dhe të provojë synimin e palëve për të mbajtur këtë marrëveshje edhe pa dispozitat e pavlefshme dhe të paefektshme. Dispozita e pavlefshme dhe e paefektshme konsiderohet të zëvendësohet nga një dispozitë e vlefshme dhe e efektshme që në termat ligjorë dhe ekonomikë është më afër me atë që synojnë palët ose do të kishin synuar në pajtim me qëllimin e kësaj marrëveshjeje nëse ato do ta kishin konsideruar këtë pikë në momentin e lidhjes së marrëveshjes.

#### 10.7 Cedimi

Huamarrësi nuk ka të drejtë të cedojë (*zedieren*) dhe transferojë nëpërmjet marrjes përsipër të kontratës (*Vertragsuebernahme*) ose të transferojë ndryshe ose të lejojë realizimin (*Einloesung*) e ndonjë të drejte, përfitimi ose detyrimi sipas kësaj kontrate.

Huadhënësi në çdo kohë mund të cedojë çdo të drejtë të tij ose të transferojë nëpërmjet marrjes përsipër të kontratës ose të transferojë apo lejojë realizimin e çdo të drejte dhe detyrimi sipas kësaj marrëveshjeje.

#### 10.8 Deklarimi i të dhënave

Huamarrësi bie dakord që: a) Huadhënësi mund të deklarojë çdo të dhënë që i vjen në dijeni në vazhden normale të marrëdhënies së biznesit me Huamarrësin në formën e zakonshme për bankat, veçanërisht për qëllimet e mbrojtjes së kreditorit, për konsolidimet e kërkuara nga rregulloret mbikëqyrëse sipas ligjit austriak për bankat ose për realizimin e transaksioneve bankare; b) në rastin e aplikimit për subvencione Huadhënësi mund të shkëmbejë çdo dokument në lidhje me financimin, të dhënat ose një informacion tjetër me institucionin përkatës dhe partnerët e tij të financimit; dhe c) autorizimi për deklarimin në pajtim me paragrafin 38, paragrafin 2, numri 5 i ligjit austriak për bankat mbetet në fuqi gjatë kohëzgjatjes së kësaj marrëveshjeje. Për më tepër,

Huadhënësi ka të drejtë të deklarojë çdo të dhënë (duke përfshirë dokumentacionin) dhe çdo të dhënë ekonomike që vjen në dijeni të tij në lidhje me raportin me klientët dhe bashkëdebitorët, garantuesit dhe persona ose shoqëri të tjera që japin garanci, si dhe çdo institucion financiar dhe shoqëri sigurimesh që marrin pjesë (ose synojnë të marrin pjesë) në huan/huamarrjen ose financimin, me personat ose shoqëritë që synojnë të përftojnë pretendimet (plotësisht ose pjesërisht) në lidhje me huan, si dhe me çdo bankë qendrore dhe në lidhje me rifinancimin e Huadhënësit. Qëllimi i deklarimit është vlerësimi i riskut.

Marrëveshja hartohet në dy kopje origjinale në gjuhën angleze. Huamarrësit i jepet një origjinal dhe Huadhënësit i jepet një origjinal.

Datë:  
Republika e Shqipërisë  
përfaqësuar nga Ministria e Financave

Datë:  
Erste Bank  
der Oesterreichischen Sparkassen AG

## ANEKSI 1 PROCEDURA E PAGESËS

Tërheqjet sipas kësaj marrëveshjeje bëhen vetëm me pagesa të drejtpërdrejta nga Huadhënësi drejtuar Qualysoftit (që është marrës i pagesave për eksportuesit e projektit sipas kontratës së dhënies së projektit) sipas procedurës së mëposhtme:

1. Qualysoft i dërgon dokumentet e mëposhtme të specifikuar në kontratën e dhënies së projektit Huadhënësit në adresën e Huadhënësit, sipas parashikimit në nenin 10.2 të marrëveshjes që Huadhënësi ia dërgon Blerësit të projektit me korrier. Në të njëjtën kohë, Huadhënësi i dërgon Huamarrësit me faks kopje të këtyre dokumenteve:

Për 10% të çmimit të projektit d.m.th., 1.031.200,00 euro si parapagesë (që është faktikisht 25% parapagim për çmimin e programit COTS):

- faturë tregtare në 1 (një) kopje origjinale dhe 4 (katër) kopje;
- një letër të parevokueshme garancie (detyrimi i përmbushjes) për 10% (dhjetë për qind) të çmimit të projektit të lëshuar nga huadhënësi në favor të Blerësit të projektit në 1 (një) kopje origjinale dhe 4 (katër) kopje.

Për 3% të çmimit të projektit, d.m.th., 309.360,00 euro, të pagueshme me aprovimin e raportit të fillimit:

- faturë tregtare në 1 (një) kopje origjinale dhe 4 (katër) kopje;
- protokollpranimi për raportin e fillimit në 1 (një) kopje origjinale dhe 4 (katër) kopje, të nënshkruara rregullisht nga Qualysoft dhe Blerësi i projektit.

Për 5% të çmimit të projektit, d.m.th., 515.600,00 euro, të pagueshme pas dorëzimit, konfigurimit dhe pranimi të pjesëve fizike:

- faturë tregtare në 1 (një) kopje origjinale dhe 4 (katër) kopje;
- protokollpranimi për pjesët fizike në 1 (një) kopje origjinale dhe 4 (katër) kopje, të nënshkruara rregullisht nga Qualysoft dhe Blerësi i projektit.

Për 30% të çmimit të projektit, d.m.th., 3.093.600,00 euro, të pagueshme të programit COTS:

- faturë tregtare në 1 (një) kopje origjinale dhe 4 (katër) kopje;
- protokollpranimi për instalimin e COTS në 1 (një) kopje origjinale dhe 4 (katër) kopje, të nënshkruara rregullisht nga Qualysoft dhe Blerësi i projektit;
- protokollpranimi për funksionalitetin e COTS në 1 (një) kopje origjinale dhe 4 (katër) kopje, të nënshkruara rregullisht nga Qualysoft dhe Blerësi i projektit;



Për 5% të çmimit të projektit, d.m.th., 515.600,00 euro, e pagueshme pas instalimit të programit, përshtatjes, lokalizimit dhe pranimi për tipat e taksave 1 dhe 2:

- faturë tregtare në 1 (një) kopje origjinale dhe 4 (katër) kopje;
- protokollpranimi për funksionalitetin modulit për tipat e taksave 1 dhe 2 në 1 (një) kopje origjinale dhe 4 (katër) kopje, të nënshkruara rregullisht nga Qualysoft dhe Blerësi i projektit.

Për 7% të çmimit të projektit, d.m.th., 721.840,00 euro, e pagueshme pas konvertimit dhe migrimit të të dhënave për tipin 2 të taksave të kompjuterizuara:

- faturë tregtare në 1 (një) kopje origjinale dhe 4 (katër) kopje;
- protokollpranimi për migrimin e të dhënave të modulit për tipin e taksave 2 në 1 (një) kopje origjinale dhe 4 (katër) kopje, të nënshkruara rregullisht nga Qualysoft dhe Blerësi i projektit.

Për 6% të çmimit të projektit, d.m.th., 618.720,00 euro, e pagueshme pas instalimit të programit, përshtatjes, lokalizimit, konvertimit dhe migrimit të të dhënave dhe pranimi për tipat e taksave 3 dhe 4:

- faturë tregtare në 1 (një) kopje origjinale dhe 4 (katër) kopje;
- protokollpranimi për funksionalitetin modulit për tipat e taksave 3 dhe 4 në 1 (një) kopje origjinale dhe 4 (katër) kopje, të nënshkruara rregullisht nga Qualysoft dhe Blerësi i projektit.
- protokollpranimi për migrimin e të dhënave të modulit për tipat e taksave 3 dhe 4 në 1 (një) kopje origjinale dhe 4 (katër) kopje, të nënshkruara rregullisht nga Qualysoft dhe Blerësi i projektit.

Për 6% të çmimit të projektit, d.m.th., 618.720,00 euro, e pagueshme pas instalimit të programit, përshtatjes, lokalizimit, konvertimit dhe migrimit të të dhënave dhe pranimi për tipat e taksave 5 dhe 6:

- faturë tregtare në 1 (një) kopje origjinale dhe 4 (katër) kopje;
- protokollpranimi për funksionalitetin modulit për tipat e taksave 5 dhe 6 në 1 (një) kopje origjinale dhe 4 (katër) kopje, të nënshkruara rregullisht nga Qualysoft dhe Blerësi i projektit;
- protokollpranimi për migrimin e të dhënave të Modulit për tipat e taksave 5 dhe 6 në 1 (një) kopje origjinale dhe 4 (katër) kopje, të nënshkruara rregullisht nga Qualysoft dhe Blerësi i projektit.

Për 6% të çmimit të projektit, d.m.th., 618.720,00 euro, e pagueshme pas instalimit të programit, përshtatjes, lokalizimit, konvertimit dhe migrimit të të dhënave dhe pranimi për tipat e taksave 7 dhe 8:

- faturë tregtare në 1 (një) kopje origjinale dhe 4 (katër) kopje;
- protokollpranimi për funksionalitetin modulit për tipat e taksave 7 dhe 8 në 1 (një) kopje origjinale dhe 4 (katër) kopje, të nënshkruara rregullisht nga Qualysoft dhe Blerësi i projektit;
- protokollpranimi për migrimin e të dhënave të modulit për tipat e taksave 7 dhe 8 në 1 (një) kopje origjinale dhe 4 (katër) kopje, të nënshkruara rregullisht nga Qualysoft dhe Blerësi i projektit.

Për 6% të çmimit të projektit, d.m.th., 618.720,00 euro, e pagueshme pas instalimit të programit, përshtatjes, lokalizimit, konvertimit dhe migrimit të të dhënave dhe pranimi për tipat e taksave 9 dhe 10:

- faturë tregtare në 1 (një) kopje origjinale dhe 4 (katër) kopje;
- protokollpranimi për funksionalitetin modulit për tipat e taksave 9 dhe 10 në 1 (një) kopje origjinale dhe 4 (katër) kopje, të nënshkruara rregullisht nga Qualysoft dhe Blerësi i projektit;
- protokollpranimi për migrimin e të dhënave të modulit për tipat e taksave 9 dhe 10 në 1 (një) kopje origjinale dhe 4 (katër) kopje, të nënshkruara rregullisht nga Qualysoft dhe Blerësi i projektit.

Për 6% të çmimit të projektit, d.m.th., 618.720,00 euro, e pagueshme pas instalimit të programit, përshtatjes, lokalizimit, konvertimit dhe migrimit të të dhënave dhe pranimi për tipat e taksave 11 dhe 12:

- faturë tregtare në 1 (një) kopje origjinale dhe 4 (katër) kopje;
- protokollpranimi për funksionalitetin modulit për tipat e taksave 11 dhe 12 në 1 (një) kopje origjinale dhe 4 (katër) kopje, të nënshkruara rregullisht nga Qualysoft dhe Blerësi i projektit;
- protokollpranimi për migrimin e të dhënave të modulit për tipat e taksave 11 dhe 12 në 1 (një) kopje origjinale dhe 4 (katër) kopje, të nënshkruara rregullisht nga Qualysoft dhe Blerësi i projektit.

Për 5% të çmimit të projektit, d.m.th., 515.600,00 euro, e pagueshme pas instalimit të programit, përshtatjes, lokalizimit dhe pranimi të shërbimeve të zakonshme:

- faturë tregtare në 1 (një) kopje origjinale dhe 4 (katër) kopje;
- protokollpranimi për modulën për shërbime të zakonshme në 1 (një) kopje origjinale dhe 4 (katër) kopje, të nënshkruara rregullisht nga Qualysoft dhe Blerësi i projektit.

Për 5% të çmimit të projektit, d.m.th., 515.600,00 euro, të pagueshme pas pranimi të testit të regresionit:

- faturë tregtare në 1 (një) kopje origjinale dhe 4 (katër) kopje;
- protokollpranimi për testin e regresionit në 1 (një) kopje origjinale dhe 4 (katër) kopje, të nënshkruara rregullisht nga Qualysoft dhe Blerësi i projekti;
- një letër të parevokueshme garancie për detyrimet e garancisë për 5% (pesë për qind) të çmimit të projektit të lëshuar nga Huadhënësi në favor të Blerësit të projektit në 1 (një) kopje origjinale dhe 4 (katër) kopje.

Të gjitha protokollat e pranimi të sipërpërmendura mund të zëvendësohen nga certifikatat për të drejtat, sipas përkufizimit të kontratës e dhënies së projektit, të lëshuara dhe nënshkruara rregullisht nga Qualysoft dhe që kanë të njëjtat efekte ligjore, si dhe protokollat e nënshkruara të pranimi.

2. Huamarrësi, pas marrjes së kopjeve të dokumenteve, udhëzon Huadhënësin me faks për të realizuar pagesën e tërheqjes përkatëse për Qualysoft (që është marrësi i pagesave për eksportuesit e projektit sipas kontratës së dhënies së projektit).

3. Në rast se Huadhënësi nuk ka marrë një udhëzim pagese nga Huamarrësi sipas parashikimit në pikën 2 dhe nuk ka marrë ndonjë kundërshtim me shkrim për pagesën e tërheqjes përkatëse me faks brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas datës së këshillimit me faks të Huadhënësit, Huamarrësi autorizon në mënyrë të pakthyeshme Huadhënësin të realizojë automatikisht pagesën e tërheqjes përkatëse për Qualysoft (që është marrësi i pagesave për eksportuesit e projektit sipas kontratës së dhënies së projektit) në ditën pasuese të punës pas periudhës 30-ditore (tridhjetë ditore).

4. Huadhënësi njofton Huamarrësin për datën e vlerës së çdo tërheqjeje me faks brenda 3 ditëve pune pasi të ketë realizuar çdo pagesë.

## ANEKSI 2 FORMULARI I MENDIMIT LIGJOR

Drejtuar: Erste Bank  
der Oesterreichischen Sparkassen AG  
att. Brigitte Schubert and Thomas Oberndorfer  
Graben 21  
A-1010 Vienna

Datë: (datë)

Unë, ....., duke vepruar në zotësinë time si Ministër i Drejtësisë i Republikës së Shqipërisë, i referohem marrëveshjes së kredisë së eksportit për një hua të butë për një shumë prej 10.312.000,00 eurosh (marrëveshja), datë ..... 2013 dhe e lidhur ndërmjet Republikës së Shqipërisë e përfaqësuar nga Ministria e Financave si huamarrës (Huamarrës) dhe Erste Bank der Oesterreichischen Sparkassen AG si huadhënësi (Huadhënës). Unë nuk shpreh asnjë mendim në lidhje me ligjet e ndonjë juridiksioni përveçse të Republikës së Shqipërisë.



Unë kam shqyrtuar një kopje të nënshkruar të marrëveshjes dhe ato dokumente të tjera që i kam konsideruar të nevojshme dhe të duhura për t'i shqyrtuar me qëllim që të jap këtë mendim. Termat e përkufizuar në marrëveshje kanë të njëjtin kuptim, përveç kur përkufizohen ndryshe.

Bazuar sa më sipër, unë jam i mendimit që:

a) Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë është e autorizuar të veprojë në emër dhe për llogari të Republikës së Shqipërisë dhe detyrojë ligjërisht Republikën e Shqipërisë. Për pasojë, detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj marrëveshjeje janë detyrime pa kufizime dhe pa kusht të Republikës së Shqipërisë. Republika e Shqipërisë mund të paditet në emër të vet në lidhje me detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj marrëveshjeje.

b) Ministria e Financave autorizohet të veprojë në emër të Huamarrësit dhe të detyrojë ligjërisht Huamarrësin. Për pasojë, të gjitha detyrimet sipas kësaj marrëveshjeje janë detyrime të vlefshme, detyruese dhe të ekzekutueshme të Huamarrësit. Huamarrësi ka zotësinë të paditë dhe të paditet në emrin e vet.

c) Huamarrësi ka kompetencën të lidhë dhe të përmbushë këtë marrëveshje. Huamarrësi ka marrë të gjitha masat e nevojshme (qeveritare dhe të tjera) për të autorizuar nënshkrimin e marrëveshjes sipas termave dhe kushteve të parashikuar në të dhe vënien në ekzekutim, shpalljen dhe përmbushjen e marrëveshjes.

d) Marrëveshja është nënshkruar nga z. .... në cilësinë e tij si Ministër i Financave të Republikës së Shqipërisë.

e) Marrëveshja e nënshkruar nga Ministri i Financave në emër të Huamarrësit përmban detyrime të ligjshme, të vlefshme dhe detyruese të Huamarrësit, të ekzekutueshme në gjykatat e Republikës së Shqipërisë në pajtim me termat e saj.

f) Personi ose personat që nënshkruajnë marrëveshjen, që nënshkruajnë ose certifikojnë një dokument tjetër në lidhje me marrëveshjen kanë të gjitha kompetencat dhe autorizimet e nevojshme për ta bërë këtë në emër të Huamarrësit.

g) Nënshkrimi dhe përmbushja e marrëveshjes dhe transaksionet e parashikuar në të nuk bien në kundërshtim me: i) asnjë ligj, rregullore apo vendim zyrtar apo gjyqësor; ii) asnjë traktat, marrëveshje ose dokument apo instrument tjetër ku Huamarrësi dhe/ose Republika e Shqipërisë është palë ose që është detyrues për të ose ndonjë prej sendeve të tij pasurore.

h) Të gjitha autorizimet, aprovimet (duke përfshirë, sipas rastit, aprovimet e kontrollit të këmbimit), pëlqimet, licencat, përjashtimet, depozitimet, regjistrimet, noterizimet dhe çdo kërkesë tjetër të institucioneve qeveritare, gjyqësore dhe publike dhe autoriteteve të nevojshme dhe të këshillueshme në lidhje me ekzekutimin, dorëzimin, vlefshmërinë dhe përmbushjen e marrëveshjes dhe çdo pagesë që bëhet sipas saj, janë marrë ose realizuar dhe janë në fuqi të plotë dhe Huamarrësi ka autoritetin e plotë të bëjë të gjitha pagesat sipas marrëveshjes në euro (euro).

i) Të gjitha shumat e pagueshme nga Huamarrësi sipas marrëveshjes mund të bëhen të lira dhe pa zbritje për llogari të tatimeve, detyrimeve, zbritjeve ose barrëve të tjera nga Republika e Shqipërisë, një nënndarje politike apo autoriteti tatimor. Në rastin e një ndalimi në lidhje me pagesat e interesit sipas marrëveshjes, detyrimi i Huamarrësit për të paguar shumat të tjera shtesë në pajtim me nenin 5.3 është i vlefshëm dhe i ekzekutueshëm.

j) Marrëveshja është ratifikuar nga Parlamenti i Republikës së Shqipërisë dhe i publikuar në gazetën zyrtare shqiptare, që quhet "Fletorja Zyrtare" dhe nuk është e nevojshme ose e këshillueshme të sigurohet ligjshmëria, vlefshmëria, ekzekutueshmëria ose pranueshmëria me prova e marrëveshjes nëpërmjet depozitimit, regjistrimit të ndonjë autoritet apo agjenci tjetër qeveritare në Republikën e Shqipërisë.

k) Zgjedhja e ligjit të Republikës së Austrisë për të rregulluar marrëveshjen është një zgjedhje e vlefshme e ligjit dhe do të njihet dhe ekzekutohet në çdo gjykatë të Republikës së Shqipërisë.

l) Huamarrësi i nënshtrohet ligjit civil në lidhje me detyrimet e tij sipas marrëveshjes. Hyrja në fuqi dhe përmbushja e marrëveshjes nga Huamarrësi përbën veprim juridik privat dhe tregtar. Heqja dorë nga imuniteti në nenin 9 të marrëveshjes është e vlefshme dhe e detyrueshme për Huamarrësin.

m) Si përjashtim, Huamarrësi nuk heq dorë nga asnjë imunitet në lidhje me ekzekutimin e një vendimi arbitrazhi, në lidhje me:

i) “ambientet e misionit” të tashme ose të ardhme sipas përkufizimit të Konventës së Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike të nënshkruar më 1961, “ambientet konsullore” të tashme ose të ardhme të përkufizuara në Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore të nënshkruar më 1963 ose ndryshe të përdorura nga një diplomat ose mision diplomatik i Shqipërisë;

ii) një pasuri e patundshme që futet në sferën e nenit 3, paragrafët 1-3 të ligjit shqiptar nr. 8743, datë 22.2.2001 “Mbi pasuritë e patundshme shtetërore”;

iii) çdo fond monetar dhe/ose shumë që është bërë tashmë e kërkueshme dhe e paguar në momentin e ekzekutimit për përmbushjen e detyrimeve të Republikës së Shqipërisë sipas së drejtës publike, traktateve, konventave dhe/ose marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkruara prej saj.

n) Nuk është e nevojshme sipas ligjit të Republikës së Shqipërisë: i) me qëllim që t’i mundësohet Huadhënësit të ekzekutojë të drejtat e tij përkatëse sipas marrëveshjes; ose ii) për shkak të nënshkrimit, shpalljes, përmbushjes dhe ekzekutimit të marrëveshjes, që Huadhënësi të licencohet, kualifikohet ose të ketë të drejtën të zhvillojë biznes në Republikën e Shqipërisë.

o) Huadhënësi nuk është as rezident, me vendbanim dhe nuk zhvillon biznes dhe nuk i nënshtrohet tatimit në Republikën e Shqipërisë për shkak të nënshkrimit, shpalljes, përmbushjes dhe ekzekutimit të marrëveshjes.

p) Dispozitat e nenit 9 të marrëveshjes janë të ligjshme, të vlefshme dhe detyruese sipas ligjit të Republikës së Shqipërisë.

q) Gjykatat e Republikës së Shqipërisë njohin çdo vendim dhe/ose vendim arbitrazhi në lidhje me marrëveshjen si të vlefshëm dhe përfundimtar dhe i ekzekutojnë këto vendime dhe/ose vendime arbitrazhi.

r) Një vendim i përcaktuar në euro (euro) do të njihet dhe ekzekutohet në Republikën e Shqipërisë.

s) Sipas njohurive të mia më të mira, asnjë gjykim, procedurë arbitrazhi apo procedurë administrative nuk zhvillohen apo janë në gjykim e sipër dhe, sipas njohurive të mia nuk kërcënohen ndaj Huamarrësit që mund të kenë si rezultat një ndryshim negativ të konsiderueshëm në gjendjen financiare të Huamarrësit.

t) Marrëveshje dhe të gjitha dokumentet e tjera nuk përmbajnë asnjë dispozitë që konsiderohet e paekzekutueshme sipas ligjit të Republikës së Shqipërisë.

u) Detyrimet e Huamarrësit sipas marrëveshjes gjithmonë renditen të barasvlershme me të gjitha detyrimet e tjera të Huamarrësit, përveç atyre detyrimeve që preferohen detyrimisht nga ligji.

Ky opinion ligjor jepet vetëm në interes të Huadhënësit dhe nuk mund t’u deklarohet personave të tjerë.

Sinqerisht juaji



ANEKSI 3  
FORMULARI I KONFIRMIMIT NË LIDHJE ME KONTRATËN E DHËNIES SË  
PROJEKTIT

Nga:       Qualysoft Ressource und Entëicklung  
             für Informationstechnologie GmbH  
             Saturn Toëer  
             Leonard-Bernstein-Straße 10  
             A-1220 Vienna

Drejtuar:  Erste Bank  
             der Oesterreichischen Sparkassen AG  
             att. Ms. Brigitte Schubert and Mr. Thomas Oberndorfer  
             Brandstätte 7 - 9  
             A-1010 Vienna

Datë:    *(datë)*

Marrëveshje kredie eksporti për 10.312.000,00 euro ndërmjet Republikës së Shqipërisë e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Erste Bank der Oesterreichischen Sparkassen AG për projektin e tatimit elektronik (marrëveshje kredie eksporti).

I dashur zotëri/zonjë,

Ne ju konfirmojmë që të gjitha kushtet (të ndryshme nga kushtet në lidhje me efektivitetin e marrëveshjes së kredisë së eksportit) për efektivitetin e kontratës së dhënies së projektit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Qualysoft Ressource und Entwicklung für Informationstechnologie GmbH and wedoIT-solutions GmbH, Austria, janë përmbushur dhe kontrata e dhënies së projektit në formën e paraqitur juve është në fuqi të plotë.

*(vendi, data)*

.....  
Qualysoft Ressource und Entwicklung für Informationstechnologie GmbH

ANEKSI 4  
FORMULARI I PRANIMIT TË EMËRTIMIT TË AGJENTIT TË PROCESIT

Drejtuar:  Erste Bank  
             der Oesterreichischen Sparkassen AG  
             att. Ms. Brigitte Schubert and Mr. Thomas Oberndorfer  
             Brandstätte 7 - 9  
             A-1010 Vienna

Datë:    *(datë)*

Marrëveshje kredie eksporti për 10.312.000,00 euro ndërmjet Erste Bank der Oesterreichischen Sparkassen AG dhe Republikës së Shqipërisë e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe për projektin e tatimit elektronik (marrëveshja).

I dashur zotëri/zonjë,

Si Ambasador i Republikës së Shqipërisë në Vjenë, Republika e Austrisë, pranoj, në emër dhe për llogari të Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë, emërimin si agent i autorizuar i Huamarrësit për shërbimet si agent i procedurës dhe në lidhje me këtë marrëveshje, adresa ime në Vjenë është:

Priz-Eugen-Straße 18/1/5, 1040 Vienna, Austria

Në vëmendje të: (emri)

Tel. (numri)

Fax. (numri)

E-mail (adresa)

Nëse do të ketë ndryshime në hollësitë e kontaktit nga ato të dhëna më sipër, unë do t'ju njoftoj me shkrim pa vonesë.

Gjithë të mirat,

.....

Ambasadori i Shqipërisë

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**

Hyri në shtyp më 14.5.2013  
Doli nga shtypi më 14.5.2013

|  |                  |
|--|------------------|
|  | Formati: 61x86/8 |
|--|------------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2013

Çmimi 40 lekë